



Financuar nga:



FONDACIONI SHOQËRIA  
E HAPUR PËR SHQIPËRINË

Lodrat! Ndhimojmë fëmijët të rriten apo  
dëmtojmë shëndetin e tyre?”

# STUDIM

*“Ky studim u realizua me mbështetjen e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë. Mendimet dhe opinionet e shprehura në të i përkasin autorëve dhe nuk përkojnë domosdoshmërisht me qëndrimet e Fondacionit”*

# Përmbajtja

<b>HYRJE</b>	<b>3</b>
<b>1.Kuadri ligjor dhe Institucional për produktet Lodra.</b>	<b>7</b>
1.1 Kuadri ligjor	7
1.1.1.Kuadri ligjor në Bashkimin Europian	7
1.1.2. Kuadri ligjor në Shqipëri	10
1.2 Kuadri Institucional	18
1.3 Bashkëpunimi Rajonal	21
1.4 RAPEX	22
<b>2.Inspektimi për produktet Lodra në Shqipëri</b>	<b>23</b>
2.1. Vlerësimi i situatës së lodrave në tregun shqiptar nga inspektimi 2016-2018	23
2.2 Marrja e kampioneve dhe metodologjia e ndjekur	25
2.2.1 Përzgjedhja e kampionëve për testim	26
2.2.2 Kategoritë/ modelet e lodrave të përzgjedhura për kontrollin laboratorik	27
2.3 Analizat sipas kampioneve dhe riskut	28
2.3.1 Rezultatet e analizave sipas kampionit dhe kategorisë së riskut	32
Tabela Nr.2: Analizat e realizuara sipas standardeve referuese të cilat rezultuan negative	33
2.3.2 Rezultatet sipas tipit/ kategorive të lodrave	35
<b>3. Kategoritë e riskut dhe ndikimi i këtyre elementëve në jetën dhe shëndetin e fëmijëve</b>	<b>39</b>
3.1 Kategoritë e riskut dhe efektet e tij.	39
3.2 Pasojat në shëndetin e fëmijëve të elementëve kimik të ndaluar/ evidentuar në lodrat e analizuara	43
3.3 Niveli i shpërndarjes së produkteve me risk serioz në treg	46
<b>4. Follow up</b>	<b>47</b>
<b>5. REKOMANDIME</b>	<b>49</b>
5.1Kuadri ligjor	49
5.2 Bashkëpunim institucional	50
5.2.2. Agjensia e Prokurimit Publik	51
5.2.3. Njësitë e qeverisjes vendore	51
5.2.4. Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve	52
5.3 Ndërgjegjësim/ sensibilizim	52
5.3.2. Konsumatorët	53
<b>Anexx 1:Terma, Akronime, Kimikate</b>	<b>54</b>

## HYRJE


Lodrat kontribuojnë në zhvillimin e fëmijëve. Loja vlerësohet nga ekspertët si pjesë thelbësore e rritjes së tyre. Lodrat ndikojnë në zhvillimin psikomotor të fëmijëve. Ato duhet të jenë në përputhje me moshën dhe zhvillimin e tyre mendor.

Prodhuesit, importuesit dhe tregtarët, të cilët vendosin lodra në tregun europian duhet të provojnë se ato janë të sigurta. Legjislacioni i Bashkimit Europian kërkon që lodrat të plotësojnë **kërkesat e sigurisë, kryesisht referuar nivelit të kimikateve në përbërjen e tyre.**

Sfida e vendosjes së lodrave të sigurta në tregun europian vazhdon të jetë një nga objektivat e Komisionit Europian, për vetë sasinë e madhe, shumëllojshmërinë dhe rrezikun e këtyre produkteve, që importohen kryesisht nga Kina. Në lëndët e para që përdoren për të prodhuar lodra mbizotëron plastika, duke krijuar risqe të shtuara për prezencë elementësh të ndaluar tek konsumatori fundor, i cili në rastin e lodrave përfshin kategorinë e fëmijëve nga 0 - 14 vjeç.

Raporti i Komisionit Europian<sup>1</sup> paraqet statistikat mbi kategoritë e produkteve të raportuara si të rrezikshme në vendet e Bashkimit Europian. Nga ky raport rezulton se lodrat janë produktet e raportuara me nivelin më të lartë të rrezikshmërisë, rreth 33% përqind, pra 1/3 e totalit të njoftimeve për produkte të rrezikshme që hiqen nga tregu i përkasin kategorisë së lodrave.

Grafiku 1. Produktet e rrezikshme të identifikuar në BE gjatë 2018 sipas kategorive




**Burimi: Raporti vjetor 2018 i sistemit të shkëmbimit të shpejtë të informacionit për mallrat e rrezikshme**

<sup>1</sup> (Raporti i RAPEX 2018)

Produktet lodra mbartin rreziqe të ndryshme, ku përmendim si risqe kryesore: kimik, fizik, elektrik/djegje etj. Alertet e njoftuara, si dhe rezultatet laboratorike tregojnë se risku kryesor për produktet lodra **vazhdon të jetë ai kimik**. Në alertet e njoftuara gjatë vitit 2018 për lodrat e hequra nga tregu, ky rrezik është prezent në rreth 45 % të rasteve.

**Grafiku 2:** Kategoritë e risqeve në produktet lodra të analizuar në tregun europian.



**Burimi:** Raporti vjetor RAPEX

Komisioni Europian duke vlerësuar në vazhdimësi të dhënat e ardhura nga autoritetet e mbikqyrjes së tregut të vendeve anëtare, ka ndërmarrë një sërë aksionesh të përbashkëta për heqjen nga tregu të mallrave të rrezikshëm në kategorinë lodra. Këto problemetë tregut të lodrave në B.E. kanë detyruar Komisionin Europian që të ndërmarrë ndryshime të rëndësishme në legjislacionin e zbatueshëm për kategorinë lodra, duke rritur standardet e sigurisë në vite. Direktiva e re 2009/48/EC “Për sigurinë e lodrave”<sup>2</sup>, në ndryshim nga Direktiva e mëparshme 88/378/EEC “Për sigurinë e lodrave”, e shfuqizuar<sup>3</sup>, parashikon kërkesa më të rrepta në lidhje me:

- Kimikatet e klasifikuara si potenciale për të shkaktuar kancer nëpërmjet ndryshimit të informacionit gjenetik, dëmtojnë gjithashtu funksionin riprodhues të fëmijëve si dhe mund të dëmtojnë një fëmijë ende të palindur. Të klasifikuara si substanca CMR<sup>4</sup> nuk lejohen të përdoren në pjesët e aksesueshme të lodrave përtej kufijve të përqendrimit të përcaktuar në Rregulloren për Klasifikimin, Etiketimin dhe

<sup>2</sup> <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32009L0048>

<sup>3</sup> <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/ALL/?uri=celex%3A31988L0378>

<sup>4</sup> Substanca kancerogjene, kryesisht janë elementët e rëndë të cilët shkaktojnë kancer te fëmijët.

Paketimin e substancave dhe përzierjeve <sup>5</sup>, përveçse nëse ato konsiderohen të sigurta pas një vlerësimi rigoroz shkencor.

- Të klasifikuar “elementë të rëndë” si: Mërkuri, Kadmium etj. nuk lejohen në pjesët e lodrave të aksesueshme për fëmijët përtej kufijve të përcaktuar në Direktivën 2009/48/ EC “Për sigurinë e lodrave”.
- Janë ndaluar 55 substanca aromatike alergjene në përbërje të lodrave. Megjithatë, 11 kategori alergjenësh mund të përdoren në lodra të caktuara me kusht që ato të jenë lehtësisht të dukshme dhe të lexueshme në etiketë, si dhe të plotësojnë kërkesat shtesë për nivelet maksimale të lejuara.

Pavarësisht kontrolleve të vazhdueshme nga ana e strukturave të mbikqyrjes së tregut në Bashkimin Europian, me objektiv vendosjen në treg vetëm të lodrave të sigurta, sërish produktet lodra zënë vendin e parë, për sa i përket përqindjes së riskut, krahasuar me produktet e tjera joushqimore në treg. Një nga arsyet kryesore që ky produkt vazhdon ende të konsiderohet me risk të lartë është shumëllojshmëria e kategorive të lodrave që prodhohen çdo ditë dhe **që shndërrohen në trende**, psh: në rastin e “*lodrave të buta*” dhe *plastelinave “slime”*. Referuar alerteve të publikuara nga KE në vitin 2018 dhe 2019 raportohen një numër i lartë i rasteve ku këto produkte janë të ndaluara për tregtim. Arsyja kryesore është prezenca e substancave kimike të rrezikshme të tilla si: N, N-dimetilformamide, N, N-dimetil-aminoethanol, ciklohexanon dhe trietilenaminë. Këto substanca dëmtojnë sytë e fëmijëve, shkaktojnë acarim të mukozës dhe dëmtim të mëlçisë si pasojë e migrimit të lartë të Boronit.




**Figura.1 a) Lodra të buta, “Squishy” Fig.2 b) Plastelinë “Slime”**

<sup>5</sup> VKM nr. 488, datë 29.6.2016 “Për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve”. Ky vendim përaftron plotësisht rregulloren (KE) nr. 1272/2008, të Parlamentit dhe Këshillit Evropian, të datës 16 dhjetor 2008, “Mbi klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e substancave dhe përzierjeve”.

## ❖ Origjina e produkteve

Pjesa kryesore e produkteve të tërhequra nga tregu i BE-së për vitin 2018 dhe 2019 raportohen të jenë me origjinë nga Kina. Nga raportimet në RAPEX të strukturave të mbikëqyrjes së tregut në vendet e BE rezulton se 10 % e lodrave të konstatuara jo në përputhshmëri me kërkesat ligjore, nuk mund t'u gjurmohet origjina e prodhimit të tyre.

**Grafiku 3 :** Origjina e prodhimit të lodrave të hequra nga tregu european jo në konformitet



**Burimi:** Raporti i shkëmbimit të shpejtë të informacionit të KE (RAPEX)

Të dhënat e Autoriteteve Doganore dhe të institucioneve të tjera, që kryejnë kontrolle dhe inspektime në tregun e produkteve lodra në Shqipëri, tregojnë se vendi i origjinës për këto produkte në pjesën dërrmuese të importeve është Kina.

Produktet lodra në Shqipëri kanë problematika të shtuara nëse krahasohen me të dhënat e strukturave mbikëqyrëse në BE, ku përmendim: mungesën e markimit CE të konformitetit ose markimit e gabuar; mungesën e dokumentacionit shoqërues teknik të produktit, përmbajtja kimike dhe rrezikshmëria fizike për fëmijët etj. Legjislacioni i hartuar për produktet joushqimore në përgjithësi dhe ai i lodrave në veçanti është i ri në Shqipëri, duke përmendur se transpozimi i direktivës së parë për lodrat në vend është i 5 (pesë) viteve të fundit. Mungesa e legjislacionit të veçantë për produktet lodra ka sjellë si pasojë mungesën e strukturës përgjegjëse për mbikëqyrjen e këtij tregu, e cila është krijuar në fillim të vitit 2016, nën varësinë e ministrisë përgjegjëse për tregtinë. Me krijimin e strukturës përgjegjëse për mbikëqyrjen e lodrave (ISHMT) produktet lodra që vendosen në tregun shqiptar janë në kontroll të vazhdueshëm, duke kërkuar zbatimin e kërkesave ligjore nga ana e operatorëve ekonomikë që operojnë në këtë treg.

## *1. Kuadri ligjor dhe Institucional për produktet Lodra.*

### **1.1 Kuadri ligjor**

#### **1.1.1. Kuadri ligjor në Bashkimin Europian**

##### ❖ **Direktiva 2009/48/EC “Mbi sigurinë e lodrave”<sup>6</sup>**

Objekti i kësaj direktive është përcaktimi i rregullave mbi sigurinë e lodrave dhe lëvizjen e lirë të tyre për tu vendosur në tregun europian. Kjo direktivë zbatohet për produkte të dizenuara ose të parashikuara për t'u përdorur në lojë, si dhe kur nuk janë ekskluzivisht të parashikuara vetëm për qëllime loje, për kategorinë e fëmijëve nga mosha 0 - 14 vjeç. Në këtë direktivë përcaktohen produktet të cilat nuk konsiderohen lodra, në kuptimin e saj.

Direktiva parashikon detyrimet e operatorëve ekonomikë ku përfshihen: prodhuesi, importuesi, përfaqësuesi i autorizuar apo shitësi me shumicë dhe pakicë. Të gjithë kategoritë e operatorëve ekonomikë në të gjithë rrjetin e tregimit janë të detyruar të vendosin në treg lodra në përputhje me kërkesat ligjore të përcaktuara në këtë direktivë.

Direktiva është amenduar disa herë përgjatë viteve, me qëllim rritjen e sigurisë së produkteve për fëmijë dhe mbrojtjen e këtyre të fundit nga lëndët e rrezikshme. Ndryshimet e miratuara nga ana e Komisionit Europian janë kryer pas propozimeve të Grupit Teknik ADCO GROUP<sup>7</sup>. Shtetet anëtare, nëpërmjet ekspertëve të mbikëqyrjes së tregut, diskutojnë mbi zhvillimet në tregun e lodrave dhe nevojat për ndryshime të mëtejshme, guida udhëzuese për implementimin sa më të saktë nga autoritetet e mbikëqyrjes së tregut.

Ndër amendimet kryesore listojmë:

**Nëntor 2019** (Direktiva EU 2019/1929): Adoptimi i vlerave specifike të limituara të kimikateve monomer dhe formaldehide në lodra të destinuar për fëmijë nga 0 - 36 muaj dhe në lodrat që mund të futen në gojë nga fëmijët. (Commission Directive (EU) 2019/1929)

**Nëntor 2019** (Direktiva EU 2019/1922): Rishikim i migrimin të limiteve të aluminit. (Commission Directive (EU) 2019/1922)

**Maj 2018** (Direktiva EU 2018/725): Rishikimi i vlerave specifike për elementin kimik chromium VI. (Commission Directive (EU) 2018/725)

<sup>6</sup> <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:02009L0048-20181126&from=EN>

<sup>7</sup> Shqipëria merr pjesë në grupet ADCO të Komisionit Europian me ekspertë të ISHMT, nga vitet 2019, ku diskutohen ndryshimet në vijim të legjislacionit europian për lodrat, ndryshime të cilat janë detyrim për transpozim në kuadër të procesit të Integritimit Europian.



- Maj 2017** (Direktiva EU 2017/898): Rishikim i limiteve të vlerave specifike për elementin kimik monomer bisphenol A në lodra të destinuarë për fëmijë nga 0 - 36 muaj ose për përdorim në gojë. (Commission Directive (EU) 2017/898)
- Maj 2017** (Direktiva EU 2017/774): Përcaktimi i vlerave limit për elementin kimik monomer dhe phenol në lodra të destinuarë për fëmijë nga 0 - 36 muaj ose për mund të përdorim në gojë. (Commission Directive (EU) 2017/774)
- Mars 2017** (Direktiva EU 2017/738): Rishikimi i niveleve të migrimit për lead. (Commission Directive (EU) 2017/738)
- Nëntor 2015** (Direktiva EU 2015/2117): Përcaktimi i niveleve limit për elementët kimik chloromethylisothiazolinone (CMI), methylisothiazolinone (MI) CMI dhe MI të miksuara bashkë në shkallën 3 me 1 (CMI/MI 3:1) në lodra të destinuarë për fëmijë nga 0 - 36 muaj ose për përdorim në gojë. (Commission Directive (EU) 2015/2117)
- Nëntor 2015** (Direktiva EU 2015/2116): Përcaktimi i vlerave limit për elementët kimik benzisothiazolinone (BIT) në lodra të destinuarë për fëmijë nga 0 - 36 muaj ose që përdoren nga fëmijët në gojë. (Commission Directive (EU) 2015/2116)
- Nëntor 2015** (Direktiva EU 2015/2115): Përcaktimi i vlerave limit për elementin kimik formamide në lodra të destinuarë për fëmijë nga 0 - 36 muaj ose ose për përdorim në gojë. (Commission Directive (EU) 2015/2115)
- Qershor 2014** (Direktiva 2014/84/EU): Ndalimi i substancave CMR nikel. (Commission Directive 2014/84/EU)
- Qershor 2014** (Direktiva 2014/81/EU): Përcaktimi i vlerave limit për elementët kimik monomer bisphenol A në lodra të destinuarë për fëmijë nga 0 - 36 muaj ose për përdorim në gojë. (Commission Directive 2014/81/EU)
- Qershor 2014** (Direktiva 2014/79/EU): Përcaktimi i vlerave limit për elementët kimik: TCEP, TCPP dhe TDCP në lodra të destinuarë për fëmijët nga 0 - 36 muaj ose që mund të futen në gojë nga ata. (Commission Directive 2014/79/EU)
- Korrik 2013** (Rregullorja nr. 681/2013): Rishikimi i vlerave limit të migrimit të bariumit. (Commission Regulation (EU) No 681/2013)
- Mars 2012** (Direktiva 2012/7/EU): Rishikimi i vlerave limit të cadmiumit. (Commission Directive 2012/7/EU).

Këto amendime janë realizuar pas kërkesave të vazhdueshme nga ana e Komisionit European apo propozimeve të vendeve të ndryshme për uljen e nivele të prezencës së metaleve të rënda



kancerogjenë (CMR), elementëve organikë, ftalateve dhe boronit, për shkak të dëmeve të pakthyeshme që shkaktojnë në shëndetin e fëmijëve.

❖ **Rregullorja KE nr. 1272/2008 “Mbi klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e substancave kimikate dhe elementëve të përzierë përbërës së tyre”**

Kjo rregullore synon të harmonizojë kriteret për klasifikimin e substancave dhe përzierieve, rregullat për etiketimin dhe paketimin e substancave dhe përzierieve të rrezikshme. Ajo synon krijimin e një inventari të klasifikimit dhe etiketimit të substancave. Kjo rregullore nuk zbatohet për ndërmjetësit jo izolues, mbeturinat, ilaçet, kozmetikën, ushqimin, lëndët ushqyese dhe substancat apo përzieriet që janë radioaktive. Jashtë fushës së zabtimit të kësaj rregulloreje janë objektet e mbikëqyrjes me porosi ose për përdorim për hulumtime shkencore dhe nuk tregtohen. Kjo rregullore nuk aplikohet për transportin e mallrave të rrezikshëm përmes rrugëve ajrore, detare, rrugore, hekurudhore ose rrugëve të brendshme, përjashto këtu etiketimin e paketimeve të jashtme, paketimit të brendshëm dhe paketimit të vetëm.

Rregullorja përcakton detyrimet e përgjithshme të prodhuesve, importuesve dhe përdoruesve për të klasifikuar, etiketuar dhe pakeluar substancat ose përzieriet. Një substancë/ përzierje e rrezikshme duhet të klasifikohet në lidhje me tiparet e saj (rreziqe fizike/ shëndetësore/ mjedisore). Rregullorja përcakton klasifikimin e rreziqeve në lidhje me identifikimin, ekzaminimin, vlerësimin e informacionit dhe vendimin për klasifikimin. Në rregullore përcaktohet dhënia e rrezikut në formën e etiketimit (përmbajtja e etiketës, piktogrameve të rrezikut, fjalët e sinjalit, vendndodhja e etiketës). Sipas dispozitave të saj duhet që paketimi të jetë i fortë dhe i qëndrueshëm për të duruar trajtimin e përgjithshëm. Nuk duhet të reagojë negativisht me përmbajtjen.

❖ **Rregullorja nr. 1907/2006 të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 18 dhjetor 2006 “Mbi regjistrimin, vlerësimin, autorizimin dhe kufizimin e kimikateve” (REACH)**

Kjo rregullore synon të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së shëndetit të njeriut dhe mjedisit. Ajo zbatohet pa paragjykuar vendin e punës në Komunitet dhe legjislacionin mjedisor. Rregullorja vendos përjashtime në produktet mjekësore, veterinare, ushqimore, kozmetike, polimere dhe disa ndërmjetës të izoluar në vend.

Substancat që i nënshtrohen kësaj rregulloreje, në përzierje ose në artikuj; në sasi prej një ton ose më shumë në vit; të destinuara për t'u vendosur në kushte normale ose të arsyeshme të parashikueshme të përdorimit, nuk do të prodhohen në Komunitet ose do të vendosen në treg, përveçse kur ato janë regjistruar në përputhje me dispozitat përkatëse. Duke përjashtuar rastet që kjo rregullore parashikon ndryshe, çdo prodhues ose importues i një substance duhet të regjistrohet në Agjencinë Europiane të Kimikateve në Helsinki. Rregullorja detajon detyrat e Agjencisë, procedurën e regjistrimit dhe shkëmbimin e njohurive ekzistuese. Ekzistojnë përjashtime nga detyrimi i përgjithshëm për t'u regjistruar për kërkime dhe zhvillim të orientuar ndaj produktit dhe procesit. Si rregull, në përputhje me nenin 4 të Direktivës 98/24/EC, duhet të bëhet një vlerësim i sigurisë kimike dhe të plotësohet një raport kimik i sigurisë për të gjitha substancat që i nënshtrohen regjistrimit në sasi prej 10 ton ose më shumë në vit për çdo regjistruar.

Një vlerësim i sigurisë kimike të një substance përfshin hapat e mëposhtëm:

- vlerësimi i rrezikut për shëndetin e njeriut;
- vlerësimi i rrezikut fiziko-kimik;
- vlerësimi i rrezikut mjedisor;
- vlerësim i vazhdueshëm, bioakumulues dhe toksik (PBT);
- vlerësim bioakumulues (vPvB).

Nëse një substancë plotëson kriteret për klasifikimin si të rrezikshme ose vlerësohet të jetë PBT ose vPvB, vlerësimi i sigurisë kimike përfshin hapa shtesë. Çdo regjistruar duhet të identifikojë dhe zbatojë masat e duhura për të kontrolluar në mënyrë të duhur rreziqet e identifikuara në vlerësimin e sigurisë kimike dhe kur është e përshtatshme, t'i rekomandojë ata në fletët e të dhënave të sigurisë.

### **1.1.2. Kuadri ligjor në Shqipëri**

Kuadri ligjor në Shqipëri për lodrat mbështetet në Direktivën 2009/48/EC “Për sigurinë e lodrave”. Kjo Direktivë është transpozuar plotësisht në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 262/2013 “Për miratimin e rregullit teknik Për sigurinë e lodrave”. Efektet e VKM-së nr. 262/2013 kanë filluar në datë 01 Qershor 2015. Kuadri ligjor për sigurinë e lodrave përfshin githashtu akte të tjera ligjore dhe nënligjore, meqënëse këto produkte përfshihen në kategorinë e kimikateve komplekse.

## ❖ Ligji nr. 27/2016 “Për menaxhimin e kimikateve”

Ky ligj ka për objekt sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së shëndetit të njeriut dhe mjedisit nëpërmjet përcaktimit të kufizimit të prodhimit, vendosjes në treg dhe përdorimit të kimikateve, përdorimit të kimikateve në artikuj, importit, eksportit të kimikateve të caktuara; sigurimin e lëvizjes së lirë të kimikateve dhe mallrave të tjera. Objekt i këtij ligji është promovimi i konkurrencës dhe inovacionit si dhe nxitja e metodave alternative për vlerësimin e rreziqeve të kimikateve. Ky ligj synon të garantojë që risqet nga substancat e rrezikshme, të cilat shkaktojnë shqetësim shumë të lartë (SVHC), të kontrollohen në mënyrën e duhur dhe që këto substanca zëvendësohen në mënyrë progresive nga substanca më pak të rrezikshme ose zbatohen teknologji ku alternativat e përshtatshme të zëvendësimit janë ekonomikisht dhe teknikisht në dispozicion.

Ai parashikon nevojën dhe detyrimin për harmonizimin e legjislacionit mbi kimikatet në Republikën e Shqipërisë me Sistemin e Harmonizuar Global për klasifikimin dhe etiketimin e kimikateve (GHS); krijimin e një sistemi të detyrueshëm për klasifikimin, etiketimin, paketimin dhe Dokumentin me të Dhënat e Sigurisë për Kimikatet (MSDS); si dhe zbatimin e Konventës së Roterdamit.

Ligji synon të krijojë infrastrukturën e nevojshme institucionale në krijimin dhe mirëmbajtjen e regjistrit të kimikateve që vendosen në tregun e brendshëm ose prodhohen për t'u eksportuar jashtë Republikës së Shqipërisë; të sigurojë depozitimin dhe ruajtjen e sigurt të kimikateve të vendosura në treg, në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e tij.

Në tëjanë parashikuar detyrimet e prodhuesve, importuesve dhe përdoruesve për të klasifikuar kimikatet që vendosen në treg dhe për të siguruar Dokumentin me të Dhënat e Sigurisë për Kimikatet; detyrimet e të gjithë furnizuesve për etiketimin dhe paketimin e kimikateve; detyrimet e eksportuesve dhe importuesve të kimikateve, që janë subjekt i dispozitave të dhënies së pëlqimit paraprak të importit dhe njoftimit të eksportit; detyrimet dhe procedurat për krijimin dhe mirëmbajtjen e regjistrit të kimikateve që vendosen në tregun e brendshëm ose që prodhohen për t'u eksportuar jashtë Republikës së Shqipërisë.

Ky ligj rregullon gjithashtu prodhimin, vendosjen në treg, përdorimin dhe eksportin e kimikateve të rrezikshme.

Ligji është vetëm pjesërisht i përafuar me legjislacionin e B.E.-së në këtë fushë.

❖ **VKM nr. 489, datë 29.6.2016 “Për miratimin e listës së substancave me rrezikshmëri shumë të lartë (Svhc) e të kriterëve për përfshirjen e substancave në listën Svhc dhe lëshimin e një autorizimi të kushtëzuar me qëllim vazhdimin e përdorimit të SVHC-ve”**

Qëllimi i këtij vendimi është të ndalohej vendosja në treg me qëllim përdorimin e mëtejshëm të SVHC-ve nga prodhuesi, importuesi ose përdoruesi profesional **pas datës 1 tetor 2019**. Për të patur një përdorim të kontrolluar të substancave SVHC deri në momentin që Shqiperia të bëhet vend anetar i BE-së dhe kur përdoruesit do të duhet të ndjekin rregullat e autorizimit sipas REACH. Ky vendim parashikon “*Autorizimin e kushtëzuar për vazhdimin e përdorimit të SVHC-ve*”, që jepet për një përdorim specifik të një substance, aplikimi për të cilin mund të bëhet deri më datë **1 tetor 2018**.

Për 31 substanca/grup substancash që gjenden të listuara sipas Shtojcës I të vendimit, është përcaktuar data përfundimtare kur lejohet vendosja në treg (1 tetor 2019). Pas tejkalimit të kësaj date, nuk lejohet vendosja në treg dhe përdorimi i asaj substance pa autorizim.

Ky vendim përcakton një periudhë tranzitore për ndalimin e vendosjes në treg për përdorimin e këtyre substancave në artikuj të caktuar deri më datë 1 Tetor 2019, duke përjashtuar në *mënyrë të menjëhershme*: - përdorimin e disa estereve të ftalatit (pika 4,5,6 sipas shtojcës I) në paketimet e produkteve medicinale që mbulohen nga legjislacioni që rregullon medikamentet dhe pajisjet mjekësore (psh ftalatet pika 4,5,6); - përdorimin e substancave të cilat sipas shtojcës klasifikohen mutagjene, kancerogjene apo toksike për riprodhimin në produktet kozmetike dhe në materialet që bien në kontakt me ushqimin, ( Pika 4, Kreu III I VKM Nr.489/2016)

Nga afati i përcaktuar për ndalimin e vendosjes në treg *përjashtohen* rastet, kur:

- a) përdorimi/et e substancës në formën e saj të pastër, në përzierje ose si përbërës i një artikulli, për të cilin substanca vendoset në treg ose përdoret nga vetë prodhuesi, importuesi ose përdoruesi profesional, është autorizuar në mënyrë të kushtëzuar nga ministria.
- b) përdorimi/et e kësaj substance në formën e saj të pastër, në përzierje ose si përbërës i një artikulli, për të cilin substanca vendoset në treg ose përdoret nga vetë ata, është përjashtuar nga kërkesa për autorizim në përputhje me përdorimet apo kategoritë e përdorimeve të përcaktuara (qëllime kërkimore, si lëndë djegëse në sisteme të mbyllura djegieje).

❖ **Vendim Nr. 488, datë 29.6.2016 “Për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve”**

Vendimi përcakton kriteret e klasifikimit të kimikateve dhe rregullat për ambalazhimin e etiketimin e kimikateve të rrezikshme; detyrimet ndaj: i) prodhuesve, importuesve dhe përdoruesve për të klasifikuar kimikatet që vendosin në treg; ii) furnizuesve për etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve; iii) prodhuesve dhe importuesve të artikujve për klasifikimin e atyre substancave që nuk janë vendosur në treg, por që janë subjekt i regjistrimit dhe njoftimit, në përputhje me ligjin në fuqi për menaxhimin e kimikateve; listën e substancave të klasifikuara dhe etiketuara në mënyrë të harmonizuar; si dhe inventarin e klasifikimit dhe etiketimit të substancave.

Ky akt nëligjor liston detyrimet për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve nga aktorë të ndryshëm të zinxhirit të shpërndarjes dhe tregtimit të tyre. Vëmendje e posaçme i kushtohet kimikateve të vendosura në treg ose që do të vendosen në treg.

❖ **VKM nr.319, datë15.5.2019 “Për kufizimet për prodhimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e disa kimikateve dhe artikujve të caktuar të rrezikshëm”**

VKM-ja përcakton kufizimet e substancave kimike shumë të rrezikshme në përdorimin e artikujve, përfshirë këtu substancat kimike të ndaluara **në lodra** dhe artikujt e fëmijëve si: takëmet e ngrënies, biberona etj. Ky akt nëligjor përcakton kufizimet dhe ndalimet e substancave kimike të cilat janë në nivel më të përhapur, ku si më problematike tek kjo kategori produkti ku përmendim grupet e ftalateve (Pika 51 dhe 52) dhe përkatësisht secili grup ftalatesh si vijon:

– **Grupi I** (DEHP, DBP, BBP);

– **Grupi II** (DINP, DIDP, DNOP) kufizohet **në një vlerë më të vogël se 0,1% të peshës së produktit lodër**. Lodrat dhe artikujt e kujdesit për fëmijë që përmbajnë këto ftalate në një përqendrim më të madh se 0,1% të peshës së materialit të plastifikuar janë të ndaluara të vendosen në treg.

Përpara miratimit të këtij akti, në tregun vendas mungonin instrumentat ligjor të nevojshëm në dispozicion të autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut për kontrollin e produkteve dhe heqjen nga tregu të këtyre artikujve, me qëllim garantimin e sigurisë së lodrave për fëmijët, në rastet e pranisë së kimikateve të rrezikshme (SVHC) të kategorizuara si toksike për riprodhimin (**kategoria IB**). Mungesa e këtyre parashikimeve ligjore ka penguar procesin e kryerjes së analizave për këtë kategori dhe në artikujt të tjerë si: tekstil, veshjet e këmbës, dorashka, detergjentë etj. Ky është akti i vetëm që rregullon sigurinë në pikëpamjen kimike.

**Kufizime të substancave të tjera të përdorimit në artikuj lodra janë:**

- **Benzeni** (Benzene): < 0,0005% në peshë të lodrës, Kancerogjene Kategoria IA, Mutagjene IB (Substanca të njohura që mund të shkaktojnë mutacione të trashëgueshme ose që konsiderohen të

tilla, nëse mund të shkaktojnë mutacione të trashëgueshme në qelizat embrionale të njerëzimit). Nëse Benzeni rezulton në një përmbajtje më të madhe se 0,0005% të peshës së lodrës nga testimet në laboratorë të akredituar, lodra është e ndaluar të vendosen në tregun evropian edhe atë shqiptar. Nëse konstatohet nga organet e mbikëqyrjes së tregut se produkte me përmbajtje më të lartë se 0,0005% të Benzenit në peshën e lodrës, ato kalojnë në ndalim të përhershëm, tërhiqen dhe shkatërrohen nga strukturat e mbikëqyrjes së tregut në bashkëpunim me operatorët ekonomikë përgjegjës për lodrat e vendosura në treg.

- **Azokolorantet dhe Azongjyruetit** (aminat aromatike) <0.003% në peshë të lodrave prej tekstili. Nëse në lodrat prej tekstili konstatohet përmbajtje të **Azokolorantet dhe Azongjyruetit** më të madh se 0.003% të peshës së lodrave prej tekstili, produkti bllokohet dhe strukturat e mbikëqyrjes së tregut në bashkëpunim me operatorët ekonomikë tërheqin dhe shkatërrojnë këto produkte që mbartin rrezik për jetën e fëmijëve.
- **Hidrokarburet Policiklike Aromatike (PAH)-të** që bien në kontakt të drejtpërdrejtë dhe të zgjatur (të vazhdueshëm) ose të ripërsëritur me afat të shkurtër me lëkurën ose me kavitetin oral, në kushte normale ose të arsyeshme të parashikuara të përdorimit, nëse përmbajnë më shumë se 0.5 mg/kg (0,00005% sipas peshës së këtij përbërësi) të ndonjë nga PAH e listuara janë të ndaluara për t'u vendosur në treg. Në të gjitha rastet, kur testet e kryera nga strukturat përgjegjëse në vendet e B.E.-së por edhe në Shqipëri, konstatohen përmbajtje më të lartë të **Hidrokarbureve Policiklike Aromatike (PAH)-të në nivelin më të madh se 0.5 mg/kg**, produktet lodra ndalohen të vendosen në treg dhe strukturat përgjegjëse në bashkëpunim me operatorët ekonomikë përgjegjës marrin masat e nevojshme për tërheqjen nga tregu, lajmërimin e konsumatorëve dhe shkatërrimin përfundimtar të këtyre produkteve.

#### ❖ **Ligji Nr. 10433/2011 “Për inspektimin në RSH”**

Ky ligj përcakton parimet e përgjithshme të inspektimit, organizimin e institucioneve publike, që kryejnë funksione inspektimi, statusin e inspektorëve, rregullat e procedimit administrativ të inspektimit dhe krijimin e funksionet e Inspektoratit Qendror.

Ky ligj është i zbatueshëm për funksionet e inspektimit në juridiksionin e pushtetit ekzekutiv të qeverisjes qendrore dhe të njëjstive të qeverisjes vendore, me përjashtim të:

- a) inspektimit të brendshëm me karakter administrativ në sektorin publik;
- b) auditimit të brendshëm në sektorin publik dhe inspektimit financiar publik;
- c) kontrollit tatimor dhe atij doganor;

- ç) inspektimit të autoritetit përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit;
- d) inspektimit të lojërave të fatit.

**❖ Ligji nr.10489/2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, i ndryshuar**

Ky ligj përcakton të drejtat dhe detyrimet e operatorëve ekonomikë, sipas rolit dhe përgjegjësisë së tyre në zinxhirin e furnizimit për vendosjen në treg të produkteve, në mënyrë që të garantojnë dhe të sigurojnë përputhshmërinë e tyre me kërkesat ligjore në lidhje me to.

Gjithashtu ligji parashikon detyrimet e personave përgjegjës të disa produkteve, grup produktesh apo instalimesh kur ato janë vënë në shërbim.

Në mënyrë të veçantë ligji rregullon mënyrën e organizimit, të drejtat dhe kompetencat e strukturës përgjegjëse, si dhe parimet për kontrollin e produkteve të importuara, që hyjnë në territorin shqiptar, në bashkëpunim me autoritetet doganore.

Brenda rregullimit të tij përfshihen të gjitha produktet joushqimore, për të cilat nuk ekziston një kuadër i veçantë ligjor dhe institucional. Ky ligj nuk zbatohet për substancat kimike që janë objekt i regjistrimit dhe/ose autorizimit paraprak dhe produktet kozmetike.

**❖ VKM nr. 36/2016 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut”**

Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, si institucion qendror publik, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për tregtinë dhe me seli në Tiranë është struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut për produktet joushqimore. Krijuar me V.K.M. vetëm në vitin 2016, ai ishte njënga detyrimet e shtetit Shqiptar ndaj Bashkimit Europian.

ISHMT-ë ka për mision garantimin e sigurisë së produkteve për konsumatorët, të vendosura në treg dhe në shërbim/ në përdorim, nëpërmjet aktiviteteve mbikëqyrëse sipas legjislacionit përkatës në fuqi. ISHMT-ja është, gjithashtu, përgjegjëse për të monitoruar respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale, si dhe të të drejtave të tjera sipas fushës së veprimtarisë institucionale.

Ky Inspektorat është struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut të produkteve të destinuara për konsumatorët, sipas legjislacionit për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore dhe legjislacionit për tregtimin e mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore, për të gjitha produktet,



shërbimet apo grup-produktet joushqimore, si dhe për inspektimin e veprimtarive turistike, sipas legjislacionit për turizmin.

ISHMT-ja në realizimin e kompetencave të saj, respekton kërkesat ligjore në fushën e:

- a) mbrojtjes së konsumatorëve, sipas përcaktimit të ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve;
- b) mbrojtjes së pronësisë industriale, sipas përcaktimit të legjislacionit për pronësinë industriale;
- c) garantimit të mbrojtjes dhe të respektimit të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, sipas përcaktimit të legjislacionit për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to;
- ç) inspektimit metrologjik, sipas legjislacionit për metrologjinë;
- d) etiketimit për konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, sipas përcaktimit të legjislacionit për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji;
- dh) kontrollin e detergjenteve të vendosura në treg sipas dispozitave të ligjit për detergjentet.

Në përmbushje të kompetencave të saj ISHMT-ë zbaton kuadrin ligjor kombëtar që lidhet me inspektimet.

#### ❖ VKM nr. 262/2013 “Për sigurinë e Lodrave”

Vendimi i Këshillit të Ministrave përcakton rregullat mbi sigurinë e lodrave dhe lëvizjen e lirë të tyre në tregun shqiptar, duke përafuar kuadrin ligjor shqiptar me acquis-in në këtë fushë.

Vendimi ka përcaktuar në mënyre kufizuese rastet e përfshira brenda fushës së zbatimit. Ai zbatohet për produkte të dizenuara ose të parashikuara për t’u përdorur në lojë, por edhe kur nuk janë ekskluzivisht të parashikuara vetëm për qëllime loje, nga fëmijë në moshën 0 -14 vjeç.

Nuk përfshihen në fushën e tij të zbatimit:

- a) pajisje të parashikuara për përdorim publik në parqe lojërash;
- b) makina automatike loje, të parashikuara për përdorim publik dhe që funksionojnë me ose pa monedhë metalike,
- c) lodra tip automjeti e pajisur me motor me djegie të brendshme;
- ç) lodra me motor me avull;
- d) hedhës dhe katapulta.

#### ❖ VKM nr. 742, datë 20.11.2019 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të shkatërrimit të produkteve”

Kuadri ligjor shqiptar ishte e paplotësuar në lidhje me procedurat e mbikëqyrjes së tregut të produkteve lodër. Për këtë arsye ishte e nevojshme përcaktimi i kuadrit ligjor dhe institucional që lidhet me shkatërrimin e produkteve që nuk plotësojnë kërkesat thelbësore të sigurisë.

Ky vendim ka për objekt përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të shkatërrimit të produkteve, me qëllim identifikimin e kushteve të nevojshme për ruajtjen, trajtimin, transportimin dhe shkatërrimin e tyre në mënyrë të tillë që mbrojtja e jetës dhe e shëndetit të njeriut e të mjedisit të jenë të garantuara. Ai zbatohet për të gjitha produktet joushqimore për konsumatorët, të vendosura në treg dhe në përdorim, të cilat i përkasin fushës së veprimtarisë së Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, sipas legjislacionit për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore dhe legjislacionit për tregtimin e mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.

Përjashtohen nga fusha e tij e zbatimit substancat kimike, që janë objekt i regjistrimit dhe/ose i autorizimit paraprak, si dhe produktet kozmetike.

**❖ Udhëzim i MZHETS nr. 177, datë 26.12.2013 “Për metodat e klasifikimit të risqeve dhe vlerësimit të riskut serioz”**

Ministria përgjegjëse për tregtinë, nga e cila varet ISHMT-ja, ka përcaktuar me udhëzim metodologjinë e vlerësimit të riskut për produktet joushqimore. Ky dokument synon t’u vijë në ndihmë strukturave të mbikëqyrjes së tregut, duke u siguruar një metodë transparente dhe praktike për të klasifikuar nivelin e riskut dhe për të vlerësuar riskun serioz për produktet joushqimore të parashikuara për përdorim nga konsumatorët.

Sipas kësaj metodologjie “Vlerësimi i riskut” është procedura e identifikimit dhe e vlerësimit të rreziqeve që konsiston në tre hapa:

- 1) identifikimi i shkallës së rrezikut;
- 2) përcaktimi i probabilitetit që një konsumator të dëmtohet nga rreziku;
- 3) kombinimi i rrezikut me probabilitetin.

Nivelet e riskut mund të jenë: serioz, i lartë, mesatar dhe i ulët.

Vlerësimi i riskut konsiderohet i përfunduar kur është identifikuar niveli më i lartë i riskut për një produkt të caktuar.

❖ **Urdhër i Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes Nr. 305, datë 30.5.2014 “Për procedurat standarde operationale të veprimtarisë së mbikëqyrjes së tregut, të detyrueshme për të gjitha strukturat e mbikëqyrjes së tregut”**

Ky udhëzim përcakton procedurat standarde operationale të veprimtarisë së mbikëqyrjes së tregut të detyrueshme për të gjitha strukturat e mbikëqyrjes së tregut.

Qëllimi i veprimtarisë së mbikëqyrjes së tregut është parandalimi i shfaqjes së rreziqeve të produkteve joushqimore në shëndetin, jetën, mjedisin apo interesa të tjera publike. Struktura e mbikëqyrjes së tregut, brenda fushës të saj të kompetencës, ka detyrimin dhe përgjegjësinë të inspektojë çdo produkt:

- a) që është shitur, shitet apo ofrohet për shitje ose çdo konsumim apo përdorim për konsumatorët;
- b) që është në zotërim ose nën kontrollin e një prodhuesi a shpërndarësi ose është i depozituar apo i shpërndarë te ndonjë person për qëllime të shitjes ose të përgatitjes për shitje, kudo që produkti të gjendet;
- c) çdo produkt/ instalim të vënë në shërbim/ në përdorim për të tretët apo publikun e gjerë, për të cilin zbatohen rregullat dhe kërkesat e sigurisë në shërbim/përdorim, kudo që produkti gjendet.

## 1.2 Kuadri Institucional

❖ **Ministria e Financave dhe Ekonomisë.**

MFE është ministria përgjegjëse për hartimin e politikave mbi sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore dhe mbrojtjen e konsumatorëve, ku përfshihen edhe produktet lodra.

Në zbatim të detyrimeve që vijnë nga procesi i integritimit europian, MFE ka transpozuar plotësisht Direktivën e lodrave që është në zbatim të vendet e Bashkimit Europian si edhe legjislacionin tjetër horizontal mbi sigurinë e produkteve joushqimore<sup>8</sup> i cili plotëson kuadrin ligjor për sigurinë e lodrave.

Ministria përgjegjëse harton politikat e përgjithshme për mbikëqyrjen e tregut me qëllim zbatimin efektiv të këtij ligji. MFE koordinon me ministrinë e linjës për hartimin e rregullave teknike të

<sup>8</sup> Ligji nr. 10480/2011 “Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore”, i ndryshuar;

Ligji nr. 10489/2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, i ndryshuar;

Ligji nr. 27/2016 “Për menaxhimin e kimikateve”.

përbashkëta<sup>9</sup> në zbatim të legjislacionit të mbikëqyrjes së tregut, kryen studime dhe paraqet propozime për hartimin dhe zhvillimin e politikave për mbikëqyrjen e tregut.

Në bashkëpunim me ISHMT, MFE realizon marrjen e masave koordinuese për zbatimin e dokumenteve strategjike në fushën e mbikëqyrjes së tregut. MFE është përgjegjëse për mbledhjen dhe shkëmbimin e informacionit me ministritë e linjës për produktet e pasigurta ose potencialisht të pasigurta, si dhe ka detyrimin për ngritjen e rrjetit të informacionit për produktet e rrezikshme në mbrojtje të konsumatorëve.

### ❖ Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut

ISHMT është struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për të garantuar sigurinë e produkteve joushqimore në treg dhe mbrojtjen e konsumatorëve. Në zbatim të Ligjit nr. 10489/2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, i ndryshuar dhe VKM nr. 262/2013 “Për sigurinë e lodrave”, ISHMT kryen kontrole në treg::

- kontroll dokumentar dhe fizik të lodrave ku përfshihet: kontrolli i markimit CE të konformitetit, Deklarata EC e konformitetit dhe dokumentacioni teknik shoqërues i produktit;
- kontroll laboratorik i produkteve lodra në rastet kur vlerësohet se dokumentacioni teknik është i pamjaftueshëm për të vlerësuar konformitetin duke qenë potencialisht një produkt me risk të lartë për fëmijët.

Në zbatim të legjislacionit mbi sigurinë e produkteve, inspektorët e ISHMT-së kanë të drejtë të kërkojnë nga ana e operatorëve ekonomikë të vendosin në dispozicion produktet për kontroll si edhe dokumentacionin e nevojshëm që shoqëron produktin. Operatorët ekonomikë duhet të vendosin në dispozicion pa pagesë produktet lodra për të kryer teste laboratorike nga ana e ISHMT-ë. Struktura përgjegjëse vlerëson në bazë të markimit të kërkuar, dokumentacionit shoqërues të produktit dhe analizave, nivelin e riskut të produktit dhe vendos nëse:

- produkt do vendoset në treg; ose
- do të tërhiqet nga tregu dhe bllokohet përkohësisht për analiza të mëtejshme.

Nëse analizat e realizuara në laboratorë të akredituar rezultojnë jashtë standardeve të përcaktuara në legjislacionin shqiptar në zbatim, produkti lodër shkon për shkatërrim.

<sup>9</sup> Disa direktiva të BE-së për shkak të objektivit të tyre, gjatë transpozimit në legjislacionin shqiptar përmbajnë detyrime për dy e më shumë ministri dhe si rrjedhim edhe zbatimi i tyre përfshin disa institucione varësie.

ISHMT-ë bashkëpunon me operatorët ekonomikë për të shmangur jokonformitetin e produkteve në të gjitha rastet kur këto mangësi mund të mënjanojnë. Në rastet kur produktet edhe pas veprimeve të operatorit ekonomik për shmangien e jokonformitetit vazhdojnë të jenë prezente, atëherë produktet bllokohen dhe shkojnë për shkatërrim.

ISHMT-ë ka objektiv të punës së tij garantimin e sigurisë së konsumatorëve dhe mbrojtjen e tyre nga produktet e pasigurta. ISHMT-ë në zbatim të Ligjit nr. 10489/2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, i ndryshuar, ka një bashkëpunim të ngushtë me autoritetet doganore, ku kryhen edhe kontrollet në pikat doganore për të ndaluar vendosjen në treg të produkteve të cilat mbartin risk të lartë për jetën dhe shëndetin e konsumatorëve, duke shmangur futjen e tyre në treg.

#### ❖ **Autoritetet Doganore**

Në zbatim të Ligjit nr. 10489/2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, i ndryshuar, Autoritetet Doganore kanë detyrimin që të kryejnë kontrolle në kufi për sa i përket produkteve joushqimore me bazë risku. Kontrollet që kryhen në doganë bazohen në vlerësimin e konformitetit të produkteve mbi Markimin CE të produktit, Deklaratën EC të konformitetit dhe dokumentacionit shoqërues teknik të tij.

Në të gjitha rastet, autoritetet doganore për një vlerësim më të hollësishëm dhe profesional kërkojnë ndihmën e ISHMT-së. Kur konstatohet se produktet që kanë kaluar në procedurë kontrolli nga ana e autoriteteve doganore janë jo në konformitet, merret masa e ndalimit për qarkullim të lirë në territorin shqiptar. Për të gjithë rastet e tjera, kur operatori ekonomik mund të marrë masat e nevojshme duke e sjellë produktin në konformitet, produkti pasi merret në rivlerësim mund të lejohet që të vendoset në treg.

#### ❖ **Institucione të tjera**

Bashkitë, kopshtet dhe shkollat, institucione të tjera të edukimit, Agjencia e Prokurimit Publik, etj. bashkëpunojnë me ISHMT-ë për të garantuar sigurinë e jetës dhe shëndetin e fëmijëve nga produktet lodra që ata blejnë apo kontratojnë, duke zbatuar standardet dhe kriteret ligjore të cilat janë të përcaktuara në legjislacionin për sigurinë e produkteve.

Si rregull, këto institucione duhet t’i drejtohen ISHMT-së, në ato raste që ato dyshojnë që lodrat mund të mbartin risk të lartë apo kanë dyshime për produkte, të cilat mund të sjellin lëndime apo

aksidente të ndryshme tek fëmijët. Nga ana e Agjencisë së Prokurimit Publik duhet të lajmërohen të gjithë Autoritetet Kontraktore të cilat kanë në objekt të punës së tyre blerjen e produkteve lodra për hartimin e specifikimeve teknike në përputhje me legjislacionin në zbatim për lodrat dhe sigurinë e produkteve joushqimore.

### **1.3 Bashkëpunimi Rajonal**

Vendet e Ballkanit Perëndimor (Bosnje Hercegovina, Mal i Zi, Kosova, Serbia, Maqedonia e Veriut, Shqipëria) kanë ngritur sistemet e tyre të mbikëqyrjes së tregut për produktet joushqimore të cilat janë struktura në përputhje me legjislacionin europian dhe duke zbatuar standardet e BE-së për produktet e prodhuara dhe importuara.

Sistemi i ngritur për shkëmbimin e informacionit të shpejtë mbi produktet e rrezikshme midis vendeve të Ballkanit Perëndimor është një model i ngjashëm me atë të shkëmbimit të informacionit për produktet me risk në vendet e BE-së. Vendet e Ballkanit Perëndimor nëpërmjet takimeve që ato realizojnë në kuadër të projekteve të ndryshme për mbikëqyrjen e tregut, kanë ngritur pikat e tyre të kontaktit për të shkëmbyer informacion periodik mbi produktet e rrezikshme që konstatohen respektivisht në vendet e tyre. Shkëmbimi i informacionit ofron të dhëna shtesë për kategoritë e produkteve me risk të lartë të cilat mund të vendosen në tregun e ballkanit perëndimor.

Nëpërmjet financimeve të BE-së, institucionet e mbikëqyrjes së tregut të ballkanit perëndimor kryejnë trajnime të vazhdueshme dhe shkëmbejnë informacione periodike mbi zhvillimet e reja në tregun e produkteve joushqimore. Njohjet reciproke të rezultateve të analizave laboratorike dhe të testeve të tjera të kryera nga ana e institucioneve të mbikëqyrjes së tregut në Ballkanin Perëndimor mbetet një nga problematikat kryesore me të cilat përballen institucionet e mbikëqyrjes së tregut.

Të dhënat mbi produktet e rrezikshme, që shpërndahen ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor aktualisht përdoren nga ana e institucioneve të mbikëqyrjes së tregut, si indicje për të kryer një hetim mbi një produkt të caktuar. Është e nevojshme që këto vende të kryejnë ndryshimet e nevojshme në kuadrin ligjor të mbikëqyrjes së tregut duke njohur reciprokisht testet e kryera nga strukturat homologe në Ballkanin Perëndimor. Njohja e testeve të kryera nga strukturat homologe ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor shmang testimet e dyfishta, sjell rritje të eficientës dhe ulje të kostove të mbikëqyrjes së tregut për secilin nga vendet pjesëmarrëse në marrëveshjen e shkëmbimit të shpejtë të informacionit mbi mallrat e rrezikshme.

## 1.4 RAPEX

Informacioni i marrë nga sistemi i shkëmbimit të informacionit të shpejtë për mallrat e rrezikshëm të Bashkimit Europian (RAPEX) ka një rëndësi të veçantë për sa i përket mbikëqyrjes së tregut të produkteve joushqimore dhe në veçanti të produkteve lodra<sup>10</sup>. Rreth 1/3 e totalit të lajmërimeve që njoftohen në RAPEX i përkasin produkteve lodra dhe ky informacion është i vlefshëm në punën e ISHMT-së në tregun shqiptar, ku rastet e pranisë së produkteve të cilat janë vlerësuar si të rrezikshme në vendet e BE-së nuk mungojnë.

Në Ligjin nr. 10489/2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, i ndryshuar, përkatësisht neni 30 përcakton se nëse këto produkte konstatohen në tregun shqiptar, merret masa e ndalimit të tregtimit të përhershëm dhe kthimi i produktit nga zinxhiri i furnizimit duke lajmëruar edhe konsumatorët në vend për riskun e mbartur nga këto produkte. Tërheqja nga tregu e produkteve të rrezikshme të cilat janë lajmëruar nga sistemi i informacionit të shpejtë të BE-së (RAPEX) është detyrë e strukturave të mbikëqyrjes së tregut ku pjesën më të madhe të kategorisë së produkteve joushqimore që raportohen në këtë sistem mbulojnë nga ISHMT.

Kategoritë e tjera të produkteve që lajmërohen në RAPEX janë produktet kozmetike, ku përgjegjës është Inspektorati Shtetëror Shëndetësor; produktet piroteknike, përgjegjësi e Policisë së Shtetit etj.

Për sa i përket kontrolleve në kufi, autoritetet doganore kanë përgjegjësinë të ndalojnë që të futen në tregun shqiptar të gjithë produktet e njoftuara nga sistemi RAPEX, në zbatim të legjislacionit në fuqi.

---

<sup>10</sup> Lodrat zënë mbi 30% të raportimeve të RAPEX dhe pjesa kryesore e këtyre raportimeve për lodra jo në konformitet lidhet me produkte që kanë vend origjine Kinën. Për shkak se të gjitha vendet janë të lidhura me produkte lodra, me importues kryesisht nga Kina, edhe njoftimet mbi produkte të rrezikshme midis vendeve të BE-së por edhe të Ballkanit Perëndimor janë të vlefshme, pasi konstatohet se këto produkte janë prezente në këto tregje, ku përfshihet edhe Shqipëria.



## *2. Inspektimi për produktet Lodra në Shqipëri*

### **2.1. Vlerësimi i situatës së lodrave në tregun shqiptar nga inspektimi 2016-2018**

Inspektimet mbi produktet lodra në treg dhe në doganë nisën me krijimin e Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut. ISHMT-ë u krijua në fillim të vitit 2016 si struktura kryesore e mbikëqyrjes së tregut për zbatimin e legjislacionit të transpozuar të BE-së për kategorinë e produkteve joushqimore. Gjatë viteve 2016 – 2018, inspektimet në treg dhe në kufi u përqendruan plotësisht në kontrollin formal të konformitetit, duke kontrolluar produktet lodra për Markimin CE dhe Deklaratën e Konformitetit. Njohja e pakët e legjislacionit mbi mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore në tërësi dhe kategorisë lodra në vecanti është konstatuar nga të gjithë operatorët ekonomikë.

ISHMT-ë gjatë 3 viteve të para të punës ka realizuar disa aktivitete sensibilizuese me operatorët ekonomikë në tregun e lodrave, të shoqëruar me vizita inspektuese me karakter informues.

Nga të dhënat e ISHMT-së rezulton se deri në tremujorin e tretë të vitit 2019 janë realizuar në total **99 inspektime në subjektet importues dhe shitës me shumicë të produkteve lodra** nga të cilat:

- 27 Inspektime me objekt kontrolli formal: Markimi CE dhe Deklarata e Konformitetit; Këto inspektime janë shoqëruar me 20 masa administrative gjobë dhe bllokim produkti për shkak të mungesës së dokumentacionit apo markimit të produkteve;
- 72 Inspektime vetëm për markimin CE të Konformitetit;

Si rezultat i këtyre inspektimeve janë vendosur nën masën e bllokimit të përhershëm, rreth 10 000 copë lodra (65 artikuj). Të gjithë artikujt e bllokuar janë shkatërruar konform legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e mjedisit.

Në muajin Dhjetor 2018, ISHMT-ë në bashkëpunim me Autoritetet Doganore nisi kontrollin në kufi mbi vlerësimin e konformitetit të produkteve lodra. Nga trajtimi i dokumentacionit shoqëruar të mallit rezultoi se nga 26 praktika doganore të përcjella për vlerësim vetëm 9 prej tyre rezultuan me dokumentacion të vlefshëm.

*Për arsye të gjetjes së subjekteve në shkelje të përsëritur dhe në mungesë të dokumentacionit apo dyshimeve mbi vlefshmërinë e dokumentacionit të paraqitur, në zbatim të legjislacionit në fuqi për sigurinë e produkteve joushqimore u vlerësua e nevojshme kalimi në fazat e mëtejshme të hetimeve dhe ekzaminimeve, ku pas kontrollit dokumentar dhe fizik u vijua me kontrollin laboratorik me objekt përputhshmërinë me kufizimet e kimikateve të rrezikshme, (përkatesisht CMR, DEHP, DBP, sipas Direktivës Reach dhe standardeve të harmonizuara EN 71-3, EN 71-12).*

Lodrat, si produkte me vend origjine Kinën dhe referuar analizës së riskut, paraqesin domosdoshmëri për kryerjen e testeve laboratorike pavarësisht se në shumë raste ato nuk shfaqin dyshime për sa i

përket markimit CE të konformitetit dhe Deklaratës EU që shoqëron modelin e lodrës. Praktika e vendeve të BE-së ka vënë në pah se jokonformiteti është konstatuar pas kryerjes së analizave. .

Risqet që paraqesin produktet lodra janë:

- Pjesa kryesore e produkteve lodra që janë të disponueshme në tregun shqiptar janë **me origjinë nga vendet jashtë BE-së, kryesisht KINA**.


- Referuar llojit të materialit të përdorur **mbizotëron plastika**, duke i klasifikuar këto produkte si kimike dhe komplekse. Në tregun shqiptar mbizotëron përdorimi i **ftalateve**, si plastifikues në PVC. Ftalatet përdoren gjithashtu

në produkte të tjera si: bojëra dhe ngjitës. Pas mesit të viteve 1990, ftalatet kanë qenë objekt i një vëmendje të veçantë, në rang ndërkombëtar, për shkak të efekteve negative që kanë në aftësitë riprodhuese, vetitë kancerogjene si dhe efektet e tyre endokrine.

- **Ftalati DEHP ( Di-etil heksil Phtalate)** është në fokus të kontrolleve sespe ndeshet zakonisht dhe përdoret globalisht në produktet lodra.

- **Modelet dhe trendet e reja** të lodrave në tregun shqiptar, ashtu si në vendet e BE-së janë konstatuar me rrezik kimik nga kontrollet e ushtruara nga Autoritetet e Mbikëqyrjes.

**Grafik 4:** Kategoritë e Lodrave sipas peshës së tyre në treg



*Burimi: Raporti vjetor I RAPEX*

Nga të dhënat e ISHMT-së rezulton se në tregun shqiptar ka produkte lodra identike me ato të njoftuara në sistemin RAPEX, për të cilat është marrë masa e ndalimit të përhershëm dhe shkatërrimit të tyre. Konstatimi i produkteve të tilla krijon dyshimin e arsyeshëm se në tregun shqiptar mund të ketë prezencë të lartë të tyre, për shkak se produktet të cilat ndalohen në tregjet e Bashkimit Europian, në shumë raste nuk shkatërrohen por rieksporohen dhe vendosen në tregje jashtë BE-së ku kontrollet janë më të pakta.

Rezultatet e inspektimeve të realizuara në treg në periudhën 2017 – 2019 nga ISHMT nxorrën në pah domosdoshmërinë e bërjes së testeve laboratorike për produktet lodra, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Legjislacioni i BE-së, i transpozuar plotësisht në kuadrin ligjor shqiptar nëpërmjet VKM nr.2 62/2013 “Për sigurinë e Lodrave”, synon të sigurojë që lodrat të plotësojnë **kërkesat e sigurisë që janë të një standardi të lartë, veçanërisht në lidhje me përdorimin e kimikateve në lodra.**

**Lodrat kategorizohen nga:**

- Sasi e madhe dhe modele të shumta;
- Origjinë nga KINA, vend me risk të lartë në prodhim;
- Materialet e përdorura, mbizotëron plastika komplekse;
- Konsumatori vulnerabel, fëmijët e moshës nga 0-14 vjeç.

Nga të dhënat e ISHMT-së për këtë kategori produkti, rezulton se një pjesë e vogël e importeve të jenë në përputhshmëri të plotë me kërkesat ligjore. Shumë produkte, të publikuara në RAPEX si lodra të rrezikshme janë prezente në tregun shqiptar.

Për të gjitha arsyet e renditura sa më sipër, kontrolli laboratorik për lodrat është i rëndësishëm për të thelluar hetimin me qëllim garantimin e mbrojtjes së jetës dhe shëndetit të konsumatorëve vulnerabel, fëmijët.

## **2.2 Marrja e kampioneve dhe metodologjia e ndjekur**

ISHMT duke përdorur metodologjinë e riskut bazuar në të dhënat e grumbulluara nga:

- (i) inspektimet në treg dhe kontrollet në doganë;
- (ii) RAPEX;
- (iii) të dhënat nga rrjeti i informacionit të shpejtë rajonal;

krijoi databazën me kategoritë dhe modelet e lodrave të cilat do tinënshtrohen analizave në laboratorë të akredituar.

Kriteri kryesor përcaktues për laboratorin ishte akreditimi i tij nga një organizëm i njohur plotësisht nga EA (European Accreditation), në përputhje me kërkesat ligjore të Ligjit nr. 10489/2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, i ndryshuar dhe akreditimi të ishte. Kriter tjetër ishte aksesueshmëria, pra sa më pranë territorit shqiptar, meqënëse në Shqipëri nuk ka laborator të akredituar për analiza të tilla. Laboratori “**Istituto Italiano Sicurezza dei Giocattoli srl**”, **COMO, ITALI** u përzgjedh is gjithëpërfshirës në analizat e akredituara për çdo standard që mbulon sigurinë e lodrave.

ISHMT nëpërmjet komunikimit me laboratorin arriti në marrëveshje për kryerjen e analizave brenda një afati 3 javor, në zbatim të procedurës së inspektimit që parashikon 30 ditë kalenderike për marrjen e një vendimi përfundimtar inspektimi.

### **2.2.1 Përzgjedhja e kampionëve për testim**

Në përzgjedhjen e mostrave me risk më lartë u vlerësuan të dhënat e mëposhtme:


- Vendi i origjinës së produktit ( Kina risk maksimal);
- Rezultatet e inspektimeve të mëparshme të lidhura me emrin e operatorit ekonomik dhe aktivitetin e tij;
- Krahasimi/ ngjashmëria e produktit lodër me modifikimet për lodrat e rrezikshme publikuar nga RAPEX apo sistemi rajonal i shkëmbimit të informacionit;
- Kategoria e lodrave me risk të lartë për sa i përket përmbajtjes së tyre (ftalateve, boronit, etj);
- Moshë e konsumatorëve për të cilën lodrat janë destinuar.

Kryerja e analizës së riskut nga ISHMT-ë për të identifikuar kategoritë e lodrave të cilat synoheshin për t'u marrë për kampionim, u krijua në bazë të të dhënave:

- Baza e të dhënave të përpunuara nga ISHMT-ë për inspektimet e mëparshme 2017-2019;
- RAPEX dhe raporti i fundit i komisionit European viti 2018;
- Kategoritë e lodrave me risk maksimal të cilat KE ka referuar si problematike, modelet e plastelinave “slime”;
- Kategoria e identifikuar me migrim të lartë të Boronit;
- RAPEX Rajonal;
- Të dhënat mbi importet nga dogana.

## 2.2.2 Kategoritë/ modelet e lodrave të përzgjedhura për kontrollin laboratorik

### Hapat Kyçe të kontrollit laboratorik



Duke vlerësuar të gjithë faktorët e mësipërm, ISHMT-ë përcaktoi me risk të lartë kategoritë:

- **Lodra plastike (kukulla) të cilat janë imitime të personazheve të filmave të animuar** (ku materiali i plastifikuar në fytyrë me përbërje plastike e butë shpesh shoqërohet nga përmbajtja e elementëve që përdoren gjatë procesit të zbutjes, ku në industri vijojnë të përdoren grupet e ftalateve (në vecanti DEHP) për shkak të kostos së ulët).
- **Slimet** janë konstatuar si trend i vitit, prezent në tregun shqiptar, me cmim shumë të ulët në shitje dhe në shumëllojshmëri produktesh. Gjatë inspektimeve përveç slimeve pa markimin përkatës të konformitetit janë konstatuar edhe produkte identike me ato të publikuara në RAPEX.
- **Rraket (Rattle)** janë konstatuar të kenë problematika në kufizimin e moshës duke mos vendosur shenjën “Ndalohet për përdorimin nga fëmijë nën 36 muaj (0-3 vjeç). Kjo shkelje ligjore është çorientuese për konsumatorin, sepse moshë për të cilën është e destinuar lodra është e qartë, për shkak të natyrës së saj/llojit. Kategoria puffer toys, lodrat e buta që mund blihen nga konsumatorët për fëmijët nën 3 vjeç. **Lodrat që kanë një paketim të papërshtatshëm**, mungesë të identifikimit të prodhuesit, mungesën e identifikimit të artikullit pa emër, numri i artikullit etj.





### 2.3 Analizat sipas kampioneve dhe riskut






Subjektet e përzgjedhura në marrjen e kampionëve për analiza janë importues në zinxhirin e furnizimit, të cilët vendosin në tregun vendas sasi të konsiderueshme të lodrave. Rreth 95% e origjinës së këtyre ngarkesave të importit është KINA.

Marrja e kampionëve është kryer në rreth **20 operatorë ekonomikë**, importues në nivelin e zinxhirit të furnizimit, në zbatim të legjislacionit në fuqi për mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore, bazuar në metodologjinë e riskut dhe historikun e rezultateve të mëparshme të inspektimeve në këto subjekte. Në zbatim të metodologjisë së riskut u morën mesatarisht 2 mostra në secilin operator ekonomik, në një total prej **42 mostra modele/ lodra** për analiza të metejshme laboratorike (renditur në tabelën si më poshtë).











Mostrat u morën në përputhje me “Urdhrin nr. 305, datë 30.5.2014 “Për procedurat standarde operationale të veprimtarisë së mbikëqyrjes së tregut, të detyrueshme për të gjitha strukturat e mbikëqyrjes së tregut”, për çdo produkt Mostër Kryesore, Rezervë dhe Mostra për procese gjyqësore, sekretuar në qese unike mostër-marrje dhe pasqyruar në procesverbal.

**Tabela Nr.1:** Mostrat e dërguara për analizë në laborator të akredituar për përputhshmërinë me standardet referuese

Nr.	Nr. i referencës së mostrës	Emri i produktit	Përshkrimi	Foto	Analiza e kërkuar	Standard referues
1.	4444269	Slime Gelatina (Green)	Lodër Slime me ngjyrë jeshile Kod (XB-035G)		Siguria e lodrave - Pjesa 3: Migrimi i disa elementëve	EN 71-3:2013 + A1:2014
2.	4444264	Plastic Toy (Yellow Duck)	Lodër në formë rosaku ngjyrë e verdhë		Siguria e lodrave - Pjesa 6: Disa estere ftalati në lodra dhe në produkte për fëmijë	ISO 8124-6:2018
3.	4444266	Squeeze me	Lodër e Butë (Squishy) me nr. Art. 2440UN me barcode 0498964000035		Siguria e lodrave - Pjesa 1: Vetitë fizike mekanike	EN 71-1:2011 + A3:2014
4.	4444193	Baby Rattle	Lodër plastike për fëmijë nën 3 vjeç, kod NO 603/ Rrake (Rattle)		Siguria e lodrave - Pjesa 1: Vetitë fizike mekanike	EN 71-1:2011 + A3:2014

5.	4444194	Toys	Lodër plastike (në formë pisotolete Uji) Toys		Siguria e lodrave - Pjesa 1: Vetitë fizike dhe mekanike	EN 71-1:2011 + A3:2014
6.	4444223	ËEI XING	Kukull Plastike +3 Vjeç, No.121		Siguria e lodrave - Pjesa 6: Disa estere ftalati në lodra dhe në produkte për fëmijë	ISO 8124-6:2018
7.	4444220	YONG	Kukull Plastike +3 Vjeç, NO:1188		Siguria e lodrave - Pjesa 6: Disa estere ftalati në lodra dhe në produkte për fëmijë	ISO 8124-6:2018
8.	4444258	BUTTERFLY RATTLE	Lodër plastike për fëmijë nën 6M+ Rrake (Rattle)		Siguria e lodrave - Pjesa 1: Vetitë fizike dhe mekanike	EN 71-1:2011 + A3:2014
9.	4444214	Microphone Frozen	Lodër Plastike me mikrofoni muzikë		Siguria e lodrave - Pjesa 1: Vetitë fizike dhe mekanike	EN 71-1:2011 + A3:2014
10.	4444217	Microphone Peppa Pig	Lodër Plastike me mikrofoni muzikë		Siguria e lodrave - Pjesa 1: Vetitë fizike dhe mekanike	EN 71-1:2011 + A3:2014
11.	4444208	L.O.L Sunrise suitcase	Lodër Plastike (Set) , NO 777-3, 777-4.		Siguria e lodrave - Pjesa 1: Vetitë fizike dhe mekanike	EN 71-1:2011 + A3:2014
12.	4444211	BEY BLADE BURST	Lodër plastike me mekanizëm mbi 3 vjeç, tip/nr kod 99100		Siguria e lodrave - Pjesa 1: Vetitë fizike dhe mekanike	EN 71-1:2011 + A3:2014
13.	4444248	Plush Toy	Lodër pellushi, ngjyerë rozë (Teddy Bear)		Siguria e lodrave - Pjesa 1: Vetitë fizike dhe mekanike	EN 71-1:2011 + A3:2014
14.	4444251	Plastic Ball	Top plastik kod TB 546		Siguria e lodrave - Pjesa 6: Disa estere ftalati në lodra dhe në produkte për fëmijë	ISO 8124-6:2018



15.	4444167	Plastic Doll Winx Club	Kukull Plastike +3 Vjeç (Personazh i animuar, WINX RM 3839)		Siguria e lodrave - Pjesa 6: Disa estere ftalati në lodra dhe në produkte për fëmijë	ISO 8124-6:2018
16.	4444163	Diversity Fashion Nr. 391,	Kukull Plastike +3 Vjeç (Personazh i animuar, Elsa Frozen)		Siguria e lodrave - Pjesa 6: Disa estere ftalati në lodra dhe në produkte për fëmijë	ISO 8124-6:2018
17.	4444228	Plastic Plush Toy	Lodër plastike ( në formë Qeni) me veshje tekstili Snoë Patrol, me bateri		Siguria e lodrave - Pjesa 1: Vetitë fizike dhe mekanike	EN 71-1:2011 + A3:2014
18.	4444238	Little Baby plastic Toy	Kukull Plastike +3 Vjeç, tip/nr /kod 8814		Siguria e lodrave - Pjesa 6: Disa estere ftalati në lodra dhe në produkte për fëmijë	ISO 8124-6:2018
19.	4444237	Charm Girl	Kukull Plastike +3 Vjeç, tip/nr kod GD-133A		Siguria e lodrave - Pjesa 6: Disa estere ftalati në lodra dhe në produkte për fëmijë	ISO 8124-6:2018
20.	4444235	Plastic rattle Baby Set	Lodër plastike për fëmijë nën 3 vjeç/ Rrake (Rattle), 8 pjesë të ndryshme		Siguria e lodrave - Pjesa 1: Vetitë fizike dhe mekanike	EN 71-1:2011 + A3:2014
21.	4444242	Plastic Doll Miraculous	Kukull per femije mbi 3 vjec, tip/nr/kod 8136; Barkode 9209293000020		Siguria e lodrave - Pjesa 6: Disa estere ftalati në lodra dhe në produkte për fëmijë	ISO 8124-6:2018
22.	4444245	Beauty horse,	Lodër plastike në formë ponny, ngjyrë bojëqielli		Siguria e lodrave - Pjesa 6: Disa estere ftalati në lodra dhe në produkte për fëmijë	ISO 8124-6:2018
23.	4444254	Lovely Baby Plastic Toy	Lodër plastike në formë bebe		Siguria e lodrave - Pjesa 6: Disa estere ftalati në lodra dhe në produkte për fëmijë	ISO 8124-6:2018
24.	4444179	Alluring Doll Plastic Doll	Kukull plastike, N.o 105		Siguria e lodrave - Pjesa 6: Disa estere ftalati në lodra dhe në produkte për fëmijë	ISO 8124-6:2018

25.	4444131	MagicEgg (Slime )	Slime në formen e vezës mosha 3vjec+ ( 12 ngjyra të ndryshme)		Siguria e lodrave - Pjesa 3: Migrimi i disa elementëve	EN 71-3:2013 + A1:2014
26.	4444109	Squishy Jelly Balls	Lodër e butë, "squishy"		Siguria e lodrave - Pjesa 6: Disa estere ftalati në lodra dhe në produkte për fëmijë	ISO 8124-6:2018
27.	4444136	Magic Clay	Plasteline ne disa ngjyra ,mosha 3 vjec +, ( 6 ngjyra të ndryshme)		Siguria e lodrave - Pjesa 3: Migrimi i disa elementëve	EN 71-3:2013 + A1:2014
28.	4444123	Police Car	"Makine policie me bateri mosha 6+ barkod 2019041500033"		Siguria e lodrave - Pjesa 6: Disa estere ftalati në lodra dhe në produkte për fëmijë	ISO 8124-6:2018
29.	4444130	Toys	rrake per femije mosha 3+, barkodi 6933355622013		Siguria e lodrave - Pjesa 1: Vetitë fizike dhe mekanike	EN 71-1:2011 + A3:2014
30.	4444128	Smash Ëater Ball	Lodër e butë, "squishy" në formë domate		Siguria e lodrave - Pjesa 6: Disa estere ftalati në lodra dhe në produkte për fëmijë	ISO 8124-6:2018
31.	4444126	Insect crystal mud (slime )	Slime me insekt lodër brenda, mosha 3+ vjeç		Siguria e lodrave - Pjesa 3: Migrimi i disa elementëve	EN 71-3:2013 + A1:2014
32.	4444152	Ferhat Ball	Lodër e butë me litar Yoyo në formë kafshësh ( Lepur, elefant, Zog, Kal në kngjyrë jeshile të verdhë, rozë dhe portokalli		Siguria e lodrave - Pjesa 1: Vetitë fizike dhe mekanike	EN 71-1:2011 + A3:2014
33.	4444153	Colored Slime	Loder slime në katër ngjyra të ndryshme		Siguria e lodrave - Pjesa 3: Migrimi i disa elementëve	EN 71-3:2013 + A1:2014
34.	4444157	Princess Fashion Doll	Kukull per femije mbi 3 vjec, tipi/nr I modelit 007		Siguria e lodrave - Pjesa 6: Disa estere ftalati në lodra dhe në produkte për fëmijë	ISO 8124-6:2018

35.	4444160	Sëeet the first	Kukull per femije mbi 3 vjec, tipi/nr i modelit 2096, barcode 693144282 0960		Siguria e lodrave - Pjesa 6: Disa estere ftalati në lodra dhe në produkte për fëmijë	ISO 8124-6:2018
36.	4444162	Moana	Kukull per femije mbi 3 vjec, tip/nr i modelit 758, barcode 6958415402312		Siguria e lodrave - Pjesa 6: Disa estere ftalati në lodra dhe në produkte për fëmijë	ISO 8124-6:2018
37.	4444229	Nuk ka	Lodër plastike në formë bebe e vogël ( me veshje dy ngjyra bojëqiell dhe rozë)		Siguria e lodrave - Pjesa 6: Disa estere ftalati në lodra dhe në produkte për fëmijë	ISO 8124-6:2018
38.	4444234	Nuk ka	Lodër kukull plastike, me flokë ngjyrë kafe		Siguria e lodrave - Pjesa 6: Disa estere ftalati në lodra dhe në produkte për fëmijë	ISO 8124-6:2018
39.	4444241	Doctor Play Set	Set me aksesori plastik (stetoskop)		Siguria e lodrave - Pjesa 6: Disa estere ftalati në lodra dhe në produkte për fëmijë	ISO 8124-6:2018
40.	4444204	Pure Latex Ballon	Tollumbace me ngjyrë të bardhë		Siguria e lodrave - Pjesa 12: Substancat N-Nitrosamina dhe N-Nitrozo	EN 71-12:2016
41.	4444196	Nuk ka	Loder plastike në formë bebe në qese të hollë		Siguria e lodrave - Pjesa 1: Vetitë fizike dhe mekanike	EN 71-1:2011 + A3:2014
42.	4444198	Nuk ka	Lodër plastike në formë helikopter në qese të hollë		Siguria e lodrave - Pjesa 1: Vetitë fizike dhe mekanike	EN 71-1:2011 + A3:2014

Burimi: ISHMT

### 2.3.1 Rezultatet e analizave sipas kampionit dhe kategorisë së riskut

Nga analizat e përcjella nga laboratorit rezultoi se **33 lodra/ modele** nuk janë në konformitet lidhur me karakteristikat fizike apo kimike.

Në përmbledhje:

- 12 Lodra janë në mospërputhshmëri me karakteristikat fizike/ mekanike (Standarti EN 71-1) që shfaqin risk të mbytjes/ gëlltitjes/ prerjeve etj.; gjenerimi i pjesëve të vogla; jo në

përputhshmëri rezultojnë edhe paralajmërimet në produkt; rreziku i gëlltimit, sofokimit nga paketimi etj

- **16 lodra/ modele me risk kimik**, nivel tepër i lartë i estereve të ftalatit (DEHP, DBP, BBP, DINP, DIDP, DNOP) mbi nivelin e lejuar <0,1 % në peshë të materialit plastik të klasifikuar si substanca me rrezikshmëri shumë të lartë (SVHC), kategoria IB me toksicitet për riprodhimin (VKM nr .489/2016 “ Për miratimin e listës së substancave me rrezikshmëri shumë të lartë (SVHC) si edhe të kritereve për përfshirjen e substancave në listën SVHC dhe lëshimin e një autorizimi të kushtëzuar me qëllim vazhdimin e përdorimit të SVHC-ve dhe VKM nr.319/2019 “Për kufizimet për prodhimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e disa kimikateve dhe artikujve të caktuar të rrezikshëm”, REACH-Regulation)
- **5 lodra të kategorisë “Slime”, me risk kimik**, nivel tepër të lartë të migrimit të metaleve të rënda (Boronit), me rrezik dëmtimi të sistemit të riprodhimit (mbi 20 herë më të larta se nivelin i lejuar 200 mg në peshën e lodrës).

**Tabela Nr.2: Analizat e realizuara sipas standardeve referuese të cilat rezultuan negative**

Nr.	Nr. referencës së mostrës	Emri i produktit	Përshkrim i mospërputhshmërisë	Kategoria e Riskut
1.	4444269	Slime Gelatina(Green )	Nivel i larte i migrimit te B (Boronit) 1124 mg/ Kg nga 300 mg/kg limiti i lejuar	Risku kimik
2.	4444266	Squeeze me	Loder jo e pershtatshme per femije nen 36 muaj; Pjesë të vogla	Risku i mbytjes
3.	4444193	Baby Rattle	Paketimi, kujdesi dhe instruksioni i perdorimit. Loder jo e pershtatshme per femije nen 36 muaj,	Risku i mbytjes
4.	4444194	Toys	Paketimi, kujdesi, Markimi CE dhe instruksioni i perdorimit. Lodër jo e pershtatshme per femije ne 36 muaj	Risku i mbytjes
5.	4444223	WEI XING	REACH), AnexxXVII, Points 51 dhe 52 perkatesisht DEHP 34.6% nga <0.1 %e lejuar dhe DBP 0.0056% nga <0.1% e lejuar (fytyra plastike e kukulles)	Risku kimik
6.	4444220	YONG	REACH),AnexxXVII,Points 51 dhe 52 perkatesisht DEHP 30.6% nga<0.1 %e lejuar, DBP 0.173% nga <0.1% e lejuar dhe DINP 0.251% nga <0.1%	Risku kimik
7.	4444258	BUTTERFLY RATTLE	Paketimi,kujdesi,markimi CE, dhe instruksioni i perdorimit. Loder jo e pershtatshme per femije ne 36 muaj (rrezikshmeri mbytjeje )	Risku i mbytjes
8.	4444208	L.O.L Sunrise suitcase	Kujdesi,markimi CE, dhe instruksioni i perdorimit. Lodër jo e pershtatshme për fëmijë nën 36 muaj(pjesë të vogla që mund të gëlltiten )	Risku i mbytjes
9.	4444211	BEY BLADE BURST	Pjese te mprehta te rrezikshme	Risku i prerjes
10.	4444251	Plastic Ball	REACH), AnexxXVII, Points 51 dhe 52	Risku kimik

			(Phtalates) perkatesisht DBP 58.2% nga <0.1% e lejuar.	
11.	4444167	Plastic Doll Winx Club	REACH), AnexxXVII, Points 51 dhe 52 perkatesisht DEHP 35.5% ( fytyra e kukullës nga<0.1 %e lejuar ; DEHP 12.7% nga<0.1 % e lejuar dhe DBP 0.705% nga <0.1% e lejuar , DINP 0.911% nga <0.1% e lejuar(trupi i kukulles)	Risku kimik
12.	4444163	Diversity Fashion Nr. 391,	REACH),AnexxXVII,Points 51 dhe 52 perkatesisht DEHP 39.3% nga<0.01 %e lejuar dhe DBP 0.825% nga <0.1% e lejuar(fytyra plastike e kukulles),DEHP 18.9% nga <0.1 % e lejuar, DBP 8.85 % nga 0.1 % dhe DINP 4,97 % nga 0.1 % e lejuar trupi i kukullës)	Risku kimik
13.	4444228	Plastic Plush Toy	Pjese të shkëputshme, rrezik gëllitje	Risku i mbytjes
14.	4444238	Little Baby	REACH),AnexxXVII,Points 51 dhe 52 perkatesisht DEHP 2.77% nga<0.1 %e lejuar(fytyra plastike e kukulles)	Risku kimik
15.	4444237	Plastic Doll Charm Girl	REACH),AnexxXVII,Points 51 dhe 52 perkatesisht DEHP 33,3% nga 0.1% vlera e lejuar, DINP 6,43% nga nga <0.1 % e lejuar (fytyra e kukulles)	Risku kimik
16.	4444235	Plastic rattle Baby Set	Format dhe madhësitë e pjeseve, kujdesi, kërkesat e përgjithshme.	Risku i mbytjes
17.	4444242	Miraculous	REACH), AnexxXVII, Points 51 dhe 52 perkatesisht DEHP 47.9% nga<0.1 %e lejuar (fytyra e kukulles) DBP 3.69% nga <0.1% e lejuar dhe DEHP 5.76% nga <0.1% (trupi i kukulles) DINP 2,1% < 0.1 %	Risku kimik
18.	4444179	Alluring Doll	REACH), AnexxXVII, Points 51 dhe 52 perkatesisht DEHP 46.3% nga<0.1 %e lejuar(fytyra e kukulles) DBP 0.572% nga <0.1% e lejuar dhe DINP 0.621% nga <0.1% (fytyra e kukulles)	Risku kimik
19.	4444131	MagicEgg (Slime )	Nivel i larte i migrimit të B (Boron) mbi 600/800/900 mg/kg në cdo ngjyrë nga <300 mg/kg vlera e lejuar e migrimit	Risku kimik
20.	4444136	Magic Clay	Nivel i larte i migrimit te B (Boron) me e madhe se 1200 mg/kg vlera e lejuar e migrimit për lodrat clay	Risku kimik
21.	4444123	Police Car	REACH), AnexxXVII, Points 51 dhe 52 perkatesisht DEHP 6.70%,7.62%,12,5 %nga<0.1 %e lejuar (Telat elektrik te makines)	Risku kimik
22.	4444130	Toys	Paketimi, kujdesi, markimi CE, dhe instruksioni i perdorimit. Loder jo e përshtatshme per femije nën 36 muaj (rrezikshmëri mbytjeje, pjesë të rrezikshme për perdorim)	Risku i mbytes/ asfiksimit
23.	4444126	Insect Crystal mud (slime )	Nivel i larte i migrimit të B (Boron) mbi 1176 mg/kg nga <300 mg/kg vlera e lejuar e migrimit	Risku kimik
24.	4444152	Ferhat Ball	Rrezikshmëri mbytjeje, pjesë të rrezikshme per perdorim	Risku i mbytjes
25.	4444153	Colored Slime	Nivel i larte i migrimit të B (Boron) mbi 2000/3000 mg/kg nga <300 mg/kg vlera e lejuar e migrimit	Risku kimik



26.	4444157	Princess Fashion Doll	REACH), AnexxXVII, Points 51 dhe 52 perkatesisht DEHP 32.5% nga <0.1 % e lejuar (fytyra plastike e kukulles)	Risku kimik
27.	4444160	Sëeet the first	REACH), AnexxXVII, Points 51 dhe 52 perkatesisht DEHP 31.3% nga <0.1 % e lejuar dhe DINP 3.48% nga <0.01% e lejuar (fytyra plastike e kukulles); DEHP 0.864% nga <0.1 % e lejuar dhe DBP 0.164% nga <0.1% e lejuar dhe DINP 0.14% nga <0.1% e lejuar (trupi i kukulles)	Risku kimik
28.	4444162	Moana	REACH), AnexxXVII, Points 51 dhe 52 perkatesisht DEHP 15.1% nga <0.1 % e lejuar dhe DINP 16.2% nga <0.1% e lejuar (fytyra plastike e kukulles)	Risku kimik
29.	4444229	Nuk ka	REACH), AnexxXVII, Points 51 dhe 52 perkatesisht DEHP 14.6% nga <0.1 % e lejuar (fytyra plastike e kukulles)	Risku kimik
30.	4444234	Nuk ka	REACH), AnexxXVII, Points 51 dhe 52 perkatesisht DEHP 28.9% nga <0.1 % e lejuar dhe DBP 0,1311% nga <0.1% e lejuar (fytyra plastike e kukulles)	Risku kimik
31.	4444241	Doctor Play Set	REACH), AnexxXVII, Points 51 dhe 52 perkatesisht DEHP 0.397% nga <0.1 % e lejuar dhe DINP 0.283% nga <0.1% e lejuar tek tetorkopi, kablli plastik i butë	Risku kimik
32.	4444196	Nuk ka	Paketimi kujdesi dhe instruksioni i perdorimit.	Risku i asfiksimit
33.	4444198	Nuk ka	Paketimi, kujdesi dhe instruksioni i perdorimit.	Risku i asfiksimit

*Burimi: Laboratori “Istituto Italiano Sicurezza dei Giocattoli srl”, COMO, ITALI ( Në anex 2:Raportet e plota të testeve të realizuara mbi mostrat nga laboratorit i akredituar)*

### 2.3.2 Rezultatet sipas tipit/ kategorive të lodrave

Niveli i mospërputhshmërisë sipas llojit/ kategorisë së lodrës për secilën kategori nga analizat e kryera është si vijon:

- Të gjitha mostrat/ lodra për kategorinë e fëmijëve të grupmohës nën 36 muaj (nga 0 – 3 vjeç) rezultuan jashtë standardeve të kërkuara. Lodrat për këtë kategori rezultuan me rrezikshmëri të lartë për sa i përket standardit për vetitë fizike dhe mekanike (EN71-1).

**Tabela Nr.3: Testet e lodrave 0-36 muaj**

**Artikulli me Nr. Ref. mostre Testi i goditjes**  
4444235 ( i 20-të në tabelën 1)



*Pas testit të goditjes rezulton se artikulli (4) sipas figurës në mes, pas testit të goditjes, gjeneron pjesë të vogla, topa të vegjël të cilët futen plotësisht tek “cilindri i pjesëve të vogla” dhe provëza e topave të vegjël.*

**Burimi: Laboratori “Istituto Italiano Sicurezza dei Giocattoli srl”, COMO, ITALI**

Rezultatet treguan se kjo kategori lodrash (për konsumatorë nga 0 – 36 muaj) janë jo në konformitet thuajse në të gjitha testet e kryera në laborator. Këto janë këmbanë alarmi për rreziqet reale që mund të shkaktojnë ku përfshihen edhe pasojat fatale për jetën e fëmijëve. Psh: gjenerimi i pjesëve të vogla nga testi i goditjes, sic ka rezultuar tek artikulli i paraqitur më lart, mund të sjellë mbytje dhe humbje të jetës tek fëmijët 0 – 36 muaj.

#### **-Kukullat plastike** (kryesisht personazhe të filmave të animuar, barbie dhe bebe)

Këto artikuj të raportuar me risk të lartë (Databaza e vlerësimit të riskut nga ISHMT dhe RAPEX) rezultuan jo në përputhshmëri/ konformitet me kufizimet e përmbajtjes të grupeve të ftalateve (51,52). Nga 16 kukulla plastike të analizuar për përputhshmërinë me standardin ISO 8124-6:2018, (*Siguria e lodrave - Pjesa 6: disa estere ftalati në lodra dhe në produkte për fëmijë*), 15 kukulla plastike u identifikuan me rrezik të përmbajtjes së dy grupeve të ftalateve në nivele shumë më të larta se kufiri i lejuar (0,1 % i peshës së lodrës), minimumi 20 herë mbi normë duke arritur edhe në përqindje jashtë çdo standarti .

*Përmbajtja më e lartë e elementëve kimik të rrezikshëm dhe të ndaluar u identifikua me ftalatin DEHP, i përqendruar kryesisht në pjesën e fytyrës së kukullës.* Nga analizat u konstatua se ftalati DINP dhe DBP gjendeshin në përbërje të shumë prej artikujve, deri në 30 herë mbi nivelin e lejuar.




**Tabela Nr.4:** Rezultatet e analizave për Artikullin Nr.17 *Miraculous*

TEST REPORT: 19.65982a		dated 17 December 2019				
SAMPLE DESCRIPTION (no. 513466)						DATE
4444242 Plastic Doll Miraculous						Test beginning: 04-12-2019 Issue date: 17-12-2019
Content of certain Phthalates (DBP, BBP, DEHP, DNOP, DINP, DIDP)						
Method: ISO 8124-6:2018				Instrument: GC-MS		
Identification Parts	DEHP	DBP	BBP	DINP	DIDP	DNOP
Soft plastic face	47,9	<0,005	<0,005	<0,005	<0,005	<0,005
Soft plastic body	5,76	3,69	<0,005	2,10	0,0257	<0,005

**Burimi:** *Burimi: Laboratori "Istituto Italiano Sicurezza dei Giocattoli srl", COMO, ITALI*

**Grafiku Nr.5:** Kukullat plastike jo në konformitet/ në konformitet



**Burimi:** *ISHMT*

- **Lodrat prej tekstili/ pellush:** nga 2 artikuj, 1 prej tyre rezultoi në moskonformitet për shkak të problemeve lidhur me vetitë fizike/ mekanike, ku pjesë të shkëputshme (sytë, hunda) shoqërohen me riskun e gëlltimit.

**Figura Nr.2 :** *Lodër Nr.17 testuar për karakteristika fizike/ mekanike EN 71-1*



- **Lodrat që fryhen top/ tollumbace** u testuan për elementët e rrezikshëm kimik. Nga analiza e kryer mbi tullumbacet (artikull 40) për nitrosaminat dhe substancat nitrosable, Nitrosaminat (Standardi EN 71-12) rezultuan në përputhje. Pavarësisht rezultateve të kësaj analize, të dhënat nga RAPEX për kategorinë tollumbace, si dhe shumëllojshmëria e tyre, e bëjnë të pamundur që kampioni të jetë përfaqësues për këtë kategori. Vlerësohet se nevojiten kontrole të tjera në treg për këtë kategori produkti.

Nga ana tjetër, produkti lodër (Top, Inflatable Toys) u **identifikua në nivele tepër të larta ftalateve, kategoria DBP, 58.2 % e peshës së lodrës nga 0.1 % e peshës që është niveli maksimal i lejuar.**

- **Slimet.** Nga 5 lodra/ slime (1 clay) 100% rezultuan në mospërputhje me Standardin EN 71-3.

Migrimi i Boronit rezultoi nga analizat në nivele tepër të larta. Gjatë kontrollit të realizuar përveç lodrave slime të analizuara, në tregun shqiptar u identifikuan një sasi e madhe e produkteve identike me ato të publikuara në RAPEX si O'barrel Slime, i publikuar mbi 6 herë nga vende të ndryshme të BE- së. Modelet u bllokuan dhe u lajmëruan operatorët ekonomikë të bëjnë tërheqjen nga rrjeti i tyre i shitjes, me qëllim shkatërrimin përfundimtar të produkteve.

- **Setet funksionale.** Të tre (3) artikujt e testuar (Artikulli Nr.11 Lol Sunrise suitcase, Artikulli Nr. 12 Bay blade Burst dhe Artikulli Nr.39 Doctor Play Set) rezultuan me risk të lartë fizik/ mekanik, përkatesisht: risk i mbytjes, risk i prerjeve dhe risk kimik.

### 3. Kategoritë e riskut dhe ndikimi i këtyre elementëve në jetën dhe shëndetin e fëmijëve


#### 3.1 Kategoritë e riskut dhe efektet e tij.

Rezultatet e analizave treguan se produktet lodra mbartin një nivel të **Riskut të lartë dhe Risk serioz** (referuar metodologjisë), duke përcaktuar marrjen e masave të ndalimit të tregtimit të produkteve dhe kthimin e tyre nga konsumatori i fundit, për të eliminuar riskun e dëmtimit të jetës dhe shëndetit të fëmijëve.

Në vlerësimin e riskut të realizuar në përputhje me metodologjinë sipas Udhëzimit të MZHETS nr. 177/2013 “Për metodat e klasifikimit të risqeve dhe vlerësimit të riskut serioz” për secilin artikull janë ndjekur këto hapa:

- 1) identifikimi i produktit që do të vlerësohet;
- 2) identifikimi i rreziqeve të produktit;
- 3) identifikimi i konsumatorit që përdor produktin;
- 4) përcaktimi i skenarëve të dëmtimit nga produkti;
- 5) vlerësimi i shkallës së dëmtimit të konsumatorit;
- 6) vlerësimi i probabilitetit të skenarëve të dëmtimit;
- 7) përcaktimi i riskut të produktit.

**Procedura ilustruhet si më poshtë:**



**Figura Nr.3** Hallkat në të cilat kalon procedura e vlerësimit të riskut

- Konsumatori: Fëmijët 0-14 vjeç → **Vulnerabël**

Në procedurën e vlerësimit të riskut të kësaj kategorie produkti (Lodrat për fëmijë), faktor kryesor që ndikon në shfaqjen e një risku të lartë apo serioz është kombinimi i rrezikut të shfaqur me kategorinë e konsumatorit, i cili në këtë rast është **konsumatori më vulnerabël**. Konsumatorët vulnerabël kanë pak mundësi të dallojnë një rrezik të mundshëm. Ata, gjithashtu, mund të veprojnë në një mënyrë që i

*bën më të ekspozuar, për shembull fëmijët e vegjël që ecin këmbadoras. Fëmijët shpesh janë të tërhequr nga produktet, si pasojë pamjes së tyre dhe kjo i bën këto produkte të paraqesin një risk të lartë në duart e tyre. Në këto raste, mbikëqyrja nga prindërit ose të rriturit parandalon fëmijët nga ekspozimi ndaj rreziqeve.*

#### - **Kategoritë e riskut**

Nga vlerësimi i rezultatet të raportit të analizave të evidentohen produkte që gjenerojnë risqet si vijojnë: **Risku i mbytjes/ Risku i Asfiksimit/ Risku i Prerjeve/ Risku Kimik** (Nivele të larta të Migrimit të Boronit, ftalateve me dëme të pakthyeshme në organizmin e fëmijëve në sistemin e riprodhimit duke shkaktuar sterilitet).

**Në rastin e kimikateve,** fëmijët janë shumë më të ndjeshëm ndaj toksicitetit të kimikateve, krahasuar me një të rritur mesatar.

#### - **Shkalla e dëmtimit**

Shkalla e dëmtimit për të gjitha kategoritë e riskut të shfaqura nga 33 produktet e testuara që kanë rezultuar me risk, vlerësohet të jetë **minimumi shkalla 2**.

Psh: Risku i gjëllitjes të pjesëve të vogla që gjenerojnë lodrat referuar edhe Tab.Nr.3 më sipër, metodologjisë për klasifikimin e riskut sjell dëme si: “ *Dëmtimi i organeve të brendshme*”, “*Bllokimi i rrugëve të frymëmarrjes*” pasi objekti i gjëllitur ngel në pjesën e sipërme të ezofagut (**shkalla e dëmtimit 3**).

Shkalla e dëmtimit në rastet e riskut kimik për shkak të niveleve mbi normën e lejuar të Boronit dhe të estereve të ftalateve është **gjithmonë 4**, pasi sjell dëme afatgjatë gjatë kontaktit me këto substanca që rezultojnë me ndikim tek sistemi riprodhues i fëmijëve .

#### - **Skenarët e mundshëm**

*Lodrat, si dhe kimikatet që ato përmbajnë, nuk duhet të çenojnë jetën ose shëndetin e përdoruesve dhe palëve të treta, kur ato përdoren si janë përcaktuar ose në mënyrën e parashikuar, **duke pasur parasysh edhe sjelljen e fëmijëve**. Aftësia e përdoruesve dhe sipas rastit, e mbikëqyrësve të tyre, duhet të merret në konsideratë, veçanërisht në rastin e lodrave të cilat janë parashikuar të përdoren nga fëmijë nga 0 - 36 muaj.*




**Niveli i riskut (RCR) i lartë dhe serioz**

❖ **Shembull: Vlerësimi i riskut testuar për karakteristikat fizike mekanike.**

Në identifikimin e produktit merren parasysh të dhënat që jepen sipas etiketës: emrin e produktit, markën, emrin e modelit, numrin e tipit/ llojit, dokumentacioni shoqërues.

Përshkrimi i produktit përfshin çdo etiketë që mund të jetë relevante për vlerësimin e riskut, në veçanti etiketat paralajmëruese. Udhëzimet e përdorimit gjithashtu duhet të përmbajnë informacionin e duhur mbi riskun e produktit dhe mënyrën për ta mbajtur këtë risk sa më ulët të jetë e mundur.

**Figura 4-5:** Produkti nr. 29 “Rrake për fëmijë” pa markime dhe identifikimin e duhur



*Burimi: ISHMT*

Në rastin e produktit nr. 29 i kategorisë “Rrake për fëmijë nën 3 vjeç” ka mangësi të theksuara si në identifikimin/ paralajmërimet.

- **Paketimi i produktit** duhet të përfshihet në çdo vlerësim të riskut. Duke vazhduar me shembullin e marrë më lart, kjo karakteristikë nuk është në përputhje me standardin referues duke qënë se *qesja plastike e paketimit është tepër e hollë (0,026 mm nga 0.038 mm që është trashësia minimale e lejuar)*. Ekziston risku i asfiksimit.

**- Identifikimi i rreziqeve**

Referuar raportit të testeve të kryera mbi këtë produkt i cili rezulton në mospërputhshmëri me karakteristikat fizike/ mekanike Standarti EN 71-1 , produkti shfaq risqet si vijojnë:

- **Risku i asfiksimit** për shkak të dimensioneve të trashësisë së qeses së ambalazhit të lodrës më e vogël se vlera minimale e lejuar 0.: Dëmtim i shkallës 3 “ Rrjedhja e oksigenit për në tru bllokohet pa pasoja të përhershme”;. Një skenar tjetër tipik dëmtimi është “Në rastin kur prindi mund të mos ndodhet në banesë, paralajmërimi për heqjen e qeses apo për mbikëqyrjen e fëmijëve gjatë përdorimit të lodrës mungon” dëmtimi mund të jetë i shkallës 4 si asfiksi fatale/mbytje.

- **Risku i Prerjes/ Risku i gëlltjes/ Pengim i rrugëve të frymëmarrjes**

Gjatë provës së *tensionit* të dy gjysmat e fluturës së gjelbër shkëputen nga lodra me një forcë minimale prej 80 N. Gjysma e shkëputur e fluturës ka pika të mprehta të arritshme (shiko Fig.6). Topi jeshil brenda fluturës bëhet i aksesueshëm dhe përshtatet tërësisht në cilindrin e pjesës së vogël (shih Fig.9). Unaza vjollcë shkëputet dhe futet plotësisht në cilindrin e pjesës së vogël (shiko Fig.7). Gjatë provës së tensionit, pjesët e topit portokalli shkëputen nga lodra me një forcë minimale prej 68 N dhe futen plotësisht në cilindrin e pjesës së vogël (shiko Fig.8). Lodrat ose ndonjë pjesë e lëvizshme e lodrave të destinuara për fëmijët nga 0 - 36 muaj nuk duhet që, pas testeve të abuzimit, të futen plotësisht në cilindrin e pjesës së vogël, të prodhojnë pika të mprehta të rrezikshme ose skajet e mprehta.



Fig 6




Fig 7



Fig 8



Fig 9

***Burimi: ISHMT***

Shkalla e më e vogël dëmtimit që sjell moskonformiteti është “Prerje Sipërfaqësore”, në pjesën e jashtme të trupit të fëmijës, por mund të shkojë deri në “Dëmtim të organeve të brendshme nga pikat e mprehta në rast gëlltije” ose “Blokimin e rrugëve të frymëmarrjes” së fëmijës.

Probabiliteti i ndodhjes së skenarëve të tillë është “Tërësisht i mundur” dhe **Shkalla e dëmtimit varion nga 2 – 4**. Niveli i riskut, **RCR** rezulton të jetë “**SERIOZ**”.

### 3.2 Pasojat në shëndetin e fëmijëve të elementëve kimik të ndaluar/ evidentuar në lodrat e analizuara

Risku kimik shkakton dëme dhe pasoja të pakthyeshme në organizmin e fëmijëve dhe referuar metodologjisë më sipër, ai kategorizohet serioz dhe i shkallës 4, duke sjellë dëme afatgjata dhe të pariparueshme në shëndet. Rezultatet nga ky studim tregojnë se kjo kategori risku, është në nivele tepër të larta tek lodrat që kanë vend origjine Kinën dhe tregtohet në Shqipëri. Analizat treguan se nga 18 lodra të testuara për përmbajtjen e estereve të ftalatit, 73 % e tyre rezultuan me përmbajtje mbi normën e lejuar (0.1 % në peshë të materialit të plastifikuar në të paktën një pjesë të lodrës). 5 slime të ndryshme të analizuar lidhur me nivelin e lartë të migrimit të Boronit rezultuan në norma të larta mbi kufijtë e lejuar. Risku kimik i shfaqur nga këto substanca kimike ka ndikim të përhershëm në sistemin e riprodhimit.

Më poshtë janë listuar disa nga këto substanca dhe ndikimi i tyre në shëndetin e fëmijëve:

#### PVC dhe Ftalatet

- **Ftalati DEHP ( Di-etil heksil Phtalate)** është objekt i vazhdueshëm i analizave, sepse është prezent dhe i zakonshëm në përbërje të lodrave në rang global. Ky studim vuri në dukje se esteret e tjera të ftalave të kufizuara nga Rregullorja REACH si: DBP (di-butil-ftalati), BBP (benzilbutilftalate) DNIP (di-isononilftalate), DIDP (di-isodecilftalate), DNOP (di-n-oktilftalatesi), substanca të klasifikuara SVHC (Substances of Very High Concern), **të kategorisë IB “Toksik për riprodhueshmërinë” (Reprotoxic -CMR) janë prezente në lodra.**

Ky grup kimikatesh përdoren kryesisht si plastifikues, pra substanca të shtuara në plastikë për të rritur fleksibilitetin, transparencën, qëndrueshmërinë dhe jetëgjatësinë e tyre. Ato përdoren zakonisht për të zbutur Polivinilklorurin (PVC). Klasifikohen gjerësisht si përçarës endokrine; ndërsa shumë studime shkencore kanë nxjerrë në pah mundësinë e ftalateve për të ndikuar në prishjen e sistemit endokrine në qeniet njerëzore. Prevalenca e plotë dhe ndikimet e tyre afatgjata në organizmin e fëmijëve ende nuk janë zbuluar përfundimisht, ndërsa studimet në këtë fushë janë në vijimësi nga një sërë institucionesh shkencore në rang global.

PVC është një plastikë e butë fleksibël. Fthalatet janë kimikate që gjenden në plastikë të butë (rrjedhin nga produktet PVC) dhe përdoren gjithashtu për të shtuar aromën e produkteve. Në thelb, çdo lodër apo material tjetër plastik që ka erë/ aromë artificiale, përmban ftalate.

*Pse duhet ti shmangim këta përbërës kimik?*



Ftalatet janë të njohura për çrregullimet endokrine (hormonale) të shoqëruara me leziona të mëlçisë dhe veshkave. Ato sjellin një rrezik të lartë në shkaktimin e llojeve të ndryshme të kancerit dhe mund të përkeqësojnë astmën dhe alergjitë tek fëmijët. Komisioni Europian ka përcaktuar kufijtë në një duzinë ftalatesh të ndryshme prezente në lodra.

Këto kimikate gjenden në nivele jashtë tolerancave të përcaktuara në legjislacionin e zbatuar në BE por edhe në atë vendas.

PVC është një kimikat tepër toksik, është i dëmshëm për trupin e njeriut dhe mjedisin, që nga faza e prodhimit deri në asgjësimin e tij. Ai përmban aditivë si: ftalate, plumb, kadium, organotina etj. që janë toksike, të cilat shkaktojnë ose nxisin astmën, alergjitë, problemet riprodhuese dhe kancerin.

Nëse një produkt është i përbërë nga PVC dhe i etiketuar “phthalate free/ nuk përmban ftalate”, PVC-të mund të përmbajë akoma aditivë të tjerë si: plumbi ose organotina. Këto të fundit janë gjithashtu toksike dhe ndikojnë në sistemin nervor qendror, lëkurën, mëlçinë, sistemin imunitar dhe sistemin riprodhues..

### **Plumbi**

Plumbi është një neurotoksinë e njohur, e cila kur gëlltitet shkakton dëmtime nervore, probleme në të mësuar dhe të sjelljes, dëmtim të sistemit riprodhues dhe dëmtim të pakthyeshëm të trurit të fëmijës. Plumbi u ndalua në bojën që përdoret për lyerjen e shtëpive ndërsa prezenca e tij u limitua më tej në ndryshimet e fundit në Direktivën e lodrave dhe Rregulloren REACH nga ana e Komisionit Europian. Është prezent në bojën e lodrave, ndonëse është i ndaluar edhe në Shqipëri.

Referuar Direktivës së Lodrave, përdorimi i plumbit në plastikë nuk është i ndaluar nëse është brenda limiteve të përcaktuara. Plumbi zbut plastikën dhe e bën atë më fleksibël, në mënyrë që të kthehet në formën e tij origjinale dhe të përdorshme për të dizenuar lodrat. Kur plastika është e ekspozuar ndaj substancave të tilla si: rrezet e diellit, ajri dhe pastruesit, lidhja kimike midis plumbit dhe plastikës prishet dhe formon pluhur duke ekspozuar kështu fëmijën tuaj ndaj migrimit të këtij metali të rëndë.

### **Bisfenolet**

Ky kimikat përdoret për të prodhuar plastikë të fortë, kryesisht plastikën transparente. BPA përdoret gjithashtu në plastike të butë. PVC, BPA dhe Bisphenols të tjerë imitojnë hormonin e estrogjenit. Ato kanë shfaqur lidhje të forta në shkaktimin dhe nxitjen e kancerit të prostatës, kancerit të gjirit, infertilitetin e femrave dhe mbipeshën. BPA është problem shqetësues endokrin, veçanërisht i

rrezikshëm, pasi sasi të vogla të këtij kimikati kanë treguar se shkaktojnë dëme serioze në sistemin riprodhues, veçanërisht kur ekspozimi shfaqet në mitër.

BPA në B.E. është i ndaluar në produktet e bebeve, që përdoren për t'i ushqyer si: shishe, qetësues etj. Direktiva e Lodrave lejon përdorimin e tyre sipas kufizime të përcaktuara. Artikujt që përmbajnë paralajmërimin "BPA free/ BPA të lirë" duhet të shikohen me kujdes, pasi BPA shpesh zëvendësohet me Bisphenols të tjerë - kimikate zëvendësues që janë po ashtu të dëmshëm për shëndetin. BPA përdoret zakonisht në bizhuteri, në lodra uji, pishina plastike, lojëra të instaluar në natyrë, por edhe në këpucë.

### **Formaldehyde**

Ky kimikat kancerogjen gjendet në disa kategori të lodrave për fëmijë. Lodrat e bëra prej druri të përbërë mund të përmbajnë ngjitës që lëshojnë formaldehyd. Kryesisht ky kimikat i rrezikshëm gjendet në ngjyrat akrilike - si me bazë tretësi ashtu edhe me bazë uji. Formaldehydi përdoret gjithashtu për të lidhur pigmente në pëlhurë (në kukulla dhe kafshë të mbushura) në mënyrë që të arrihet rezistencë ndaj rrudhave dhe përtëritjes së ujit.

### **Boroni**

Migrimi i Boronit mbi nivelet e lejuara (200mg/kg) në lodrat e kategorisë slime është një nga problemet me të cilat po përballen vendet e BE-së, për shkak të shpërndarjes së lartë në treg. Gëlltitja ose kontakti me një sasi të tepërt të boronit ndikon negativisht në shëndetin e fëmijëve duke dëmtuar sistemin e tyre riprodhues.

Në përputhje me standartin EN 71-3, niveli i boronit nuk duhet të kalojë kufijtë e migrimit mbi 1200mg/kg në produktet "Clay" në formë allçie, që punohen me dorë.,

Burimet zyrtare dhe komunikatat t BE-së vënë në dukje se kimikatet e ndaluara **gjenden në lodra më shumë se çdo lloj produkti tjetër**. Për vitin 2018, K.E. publikoi lajmërimet për 290 lodra të gjetura me nivele të paligjshme të substancave toksike të ndaluara, duke ngritur alarmin se ato mund të shkaktojnë kancer, autizëm dhe defekte në lindje. Probleme të tjera shëndetësore të shkaktuara në organizmin e fëmijëve mund të jenë pasojë e kimikateve të ndaluara, por këto janë ende objekt i studimeve të mëtejshme. Raporti i KE-së për vitin 2018 tregoi se rreth 250 lodra bënin pjesë te kategoria e plastikës komplekse, 150 ishin kukulla plastike/ personazhe, 21 ishin modele clay ose slime dhe 31 ishin tollumbace ose topa.

Raportet e KE-së kanë theksuar se nga të gjithë produktet joushqimore, lodrat janë kategoria me problemet më të mëdha në testet kimike të realizuara, duke kaluar në shumë raste nivelet limit të përcaktuara në legjislacionin komunitar. Në rang europian, për vitin 2018, numri i kampioneve me probleme të produkteve lodra është shumë i lartë, krahasuar me veshjet (numri i kampioneve me probleme 42), kozmetikë (numri i kampioneve me probleme 91), stoli (numri i kampioneve me probleme 51) dhe pajisje mbrojtëse (numri i kampioneve me probleme 5),. Nga 1.996 produkte/modele të të gjitha llojeve të testuara në laborator nëpërmjet testeve komplekse, analizat rezultuan se në lodra 563 teste kimike konkluduan të dështuara.

### **3.3 Niveli i shpërndarjes së produkteve me risk serioz në treg**


Gjatë fundit të vitit 2019, produkte lodra me rezultat negativ të testuar në laborator u konstatuan rreth 10 000 copë, ndërsa përhapja ishte uniforme për sa i përket subjekteve të cilat vend origjine të prodhimit kishin Kinën.

Gjatë inspektimeve u identifikuan lodra të cilat rezultuan me risk të lartë për sa i përket kontrollit formal, ku përfshihet: mungesa e markimit dhe dokumentacioni teknik, në një sasi prej rreth 2000 copë. Nga inspektimet rezultuan se produkte të cilat u evidentuan si kampione me probleme nga analizat laboratorike ishin importuar paralelisht nga operatorë të ndryshëm ekonomikë. Përlllogaritjet statistikore tregojnë se sasia e bërë e disponueshme në treg për konsumatorët fundorë, të jetë minimalisht 50 % më e lartë se ajo e identifikuar fizikisht nga kontrollet në treg për produkte të identifikuara në moskonformitet. Referuar shpërndarjes gjeografike, lodrat të cilat u konstatuan me risk serioz tregtohen kryesisht në qytetin e Tiranës, Durrësit dhe Fierit.

#### 4. Follow up

Përfundimi i procesit të inspektimit, marrja e vendimit përfundimtar të ndalimit të përhershëm të tregtimit, vendimi për shkatërrimin/ bërjes jofunkionale të këtyre artikujve u shoqërua me detyrime të tjera ndaj subjekteve importuese, përgjegjëse për vendosjen në tregun shqiptar të këtyre lodrave. Këtyre subjekteve dhe strukturave të tjera të përfshira në zinxhirin e shpërndarjes dhe tregtimit iu la detyrimi për kthimin e produktit nga zinxhiri i furnizimit, pra nga shpërndarësit, njoftimin e konsumatorit mbi rrezikun, kthimin e produktit si dhe rimbursimin e konsumatorit.

**Figura 10:** Hapat e ndjekur pas marrjes së rezultateve nga ISHMT “ FOLLOW UP



**Burimi:** ISHMT

ISHMT ka përcjellë informacionin i nevojshëm për prindërit nëpërmjet mediave të ndryshme, duke kërkuar rritjen e ndërgjegjësimit të konsumatorëve për të kontrolluar për markimin CE të konformitetit në produktet lodra, por edhe zbatimin e standardeve të tjera në prodhim, përpara se lodra të bëhet e disponueshme në treg.

Drejtoria e Përgjithshme të Doganave u njoftua për produktet e identifikuar dhe subjektet importuese, me qëllim ndalimin e vendosjes për qarkullim të lirë të këtyre artikujve në tregun shqiptar pas kontrollit fizik doganor.

ISHMT-ë publikoi në websitin zyrtar listën e lodrave me risk serioz, në formën e POP-up.

Analizat përfundimtare të lodrave u skeduan në formatin e RAPEX dhe u shpërndanë në pesë (5) vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, nëpërmjet sistemit të shpërndarjes së informacionit të shpejtë. ISHMT njoftoi autoritetet e mbikëqyrjes së tregut në vendet e Ballkanit Perëndimor (RAPEX RAJONAL) për secilën nga produktet lodër, me të dhënat specifike të detajuara për identifikimin e tyre/ kategorinë e riskut dhe arsyeja e mospërputhshmërisë së tyre me standardet referues.

## 5. REKOMANDIME

### 5.1 Kuadri ligjor

Në përfundim të fazës së plotë të inspektimeve të produkteve lodra, në tregun e importit, tregtimit me shumicë dhe pakicë rezulton se ekzistojnë problematika në kuadrin ligjor dhe rregullator të cilat duhet që të adresohen drejt institucioneve përkatëse, për të ndryshuar apo amenduar ligjet dhe aktet e tjera nënligjore.

Propozojmë ndryshimet e mëposhtme:

1. Në Ligjin nr. 10489/2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, të bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:
  - (i) **Në nenin 38 të shtohet pika 2**, me këtë përmbajtje :
 

“ Marrja e vendimit përfundimtar nga ana e strukturës përgjegjëse duhet të kryhet brenda një afati prej 60 ditë pune.”
  - (ii) **Gërma b, pika 1, neni 29**, riformulohet me këtë përmbajtje:
 

“ Kontrolleve fizike dhe laboratorike në bazë të mostrave, kur është e përshtatshme. Marrja e këtyre masave bëhet mbështetur në udhëzimin për përcaktimin e riskut të produkteve joushqimore miratuar nga Ministri përgjegjës për tregtinë, parimet e vlerësimit të riskut, ankesat dhe informacione të tjera”.
  - (iii) **Gërma b, pika 2, neni 29**, riformulohet me këtë përmbajtje:
 

“ Të hyjnë në qendrat e punës të operatorëve ekonomikë dhe të marrin mostrat e nevojshme të produkteve, kur është e nevojshme dhe e justifikuar. Këto kontrolle përfshijnë edhe marrjen e mostrave të produkteve gjatë monitorimit dhe mbikëqyrjes së tregut, në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë Ligj”.
2. Në **VKM- nr. 262/2013**, Për miratimin e rregullit teknike “Për sigurinë e lodrave”, të bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:
  - (i) Në pikën 8.3.11 “Lodrat ose komponentët e lodrave nuk duhet të tejkalojnë limitet e mëposhtme ndryshohet:

- “Migrimi i Plumbit (Pb) limitohet në nivelet 2.0 mg/kg në të thatë, 0.5 mg/kg I thyeshëm, 23 mg/kg pluhur”.

3. Në Ligjin Nr. 10433/2011 “Për inspektimin në RSH”, të bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

(i) **Të miratohet VKM në zbatim të pikës 7, Neni 38, me përmbajtje:**

*Miratimi me një vendim të KM sipas pikës 7, neni 38 i Ligjit 10433/2011 “Për inspektimin në RSH”, ku të përcaktohen procedura të hollësishme për marrjen dhe trajtimin e mostrave, sipas tipit të inspektimit, si dhe të përcaktohet qartë metodologjia e llogaritjes së shpenzimeve të transportit të tyre dhe shpenzimeve të tjera, për cdo operator ekonomik. Hartimi i metodologjisë me një VKM është domosdoshmëri pasi marrja e mostrave, transportimi dhe shpenzimet e tjera mund të përfshijnë një numër të caktuar subjektsh ekonomik në të njëjtën kohë dhe ndarja e saktë e shpenzimeve midis tyre, sipas peshës specifike të mostrave për cdo subjekt, nuk mund të kryhet pa patur një metodologji të plotë..*

4. Në Ligjin nr. 9643/2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar , të bëhen ndryshimet dhe shtesat dhw pwrkatwsisht nw Neni 7 tw kwtij Ligji , tw shtohet pika f, me përmbajtje:

- “ Shërbimi i kryerjes së analizave dhe testeve të tjera në laboratorë të akredituar jashtë vendit, kur në vend nuk ka laboratorë të tillë”.

## 5.2 Bashkëpunim institucional

### 5.2.1 Bashkëpunimi me Autoritetet Doganore.

Një nga hallkat më të rëndësishme të autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut në vendet e Bashkimit European është bashkëpunimi midis institucioneve publike për të rritur eficencën në mbikëqyrjen e tregut. Tregu shqiptar, në pjesën dërmuese të produkteve joushqimore, mbizotërohet nga importi. Autoritetet Doganore kanë një rol të rëndësishëm dhe thelbësor në garantimin e sigurisë së produkteve joushqimore që vendosen në treg. ligji nr. 10489/2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, i ndryshuar përcakton rolin e Autoriteteve Doganore në këtë proces. Ky proces,në pjesën më të madhe të rasteve, shoqërohet me kërkesën e Autoriteteve Doganore për një vlerësim më të thelluar nga ana e Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut. Për këtë qëllim është i nevojshëm hartimi dhe miratimi i një marrëveshje bashkëpunimi midis dy institucioneve ku të përcaktohen në mënyrë të detajuar procedurat dhe veprimet që ndërmerren në



çdo rast për të ndihmuar procesin dhe uljen e barrës së pritjes në doganë nga ana e operatorëve ekonomikë.

### **5.2.2. Agjensia e Prokurimit Publik**

Agjensia e Prokurimit Publik është institucioni kryesor përgjegjës për kontrollin e sistemit të blerjeve nga ana e institucioneve publike dhe për zbatimin e legjislacionit për prokurimin publik.

Ajo duhet të hartojë një manual të detyrueshëm zbatimi për të gjithë institucionet shtetërore të cilat kryejnë blerje të produkteve lodra. Në këtë manual duhet të jenë të përcaktuara specifikimet teknike për kategorinë e produkteve lodra, ku të përcaktohen kërkesat ligjore të detyrueshme për t'u zbatuar nga operatori ekonomik që merr pjesë në një procedurë prokurimi publik, pavarësisht formës së saj, sipas përcaktimeve në VKM nr. 262/2013 "Për sigurinë e Lodrave".

Ky manual duhet që të përcaktojë se çdo operator ekonomik që merr pjesë në një ofertë lodrash për institucionet publike, për çdo model lodre duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor për:

- Markimin CE të produktit, numrin serial, gjuhën shqipe të etiketimit dhe elementët e tjerë që përcaktojnë moshën e përdorimit të lodrës në etiketën e produktit;
- Deklaratën e Konformitetit të produktit sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 10489/2011 "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore", i ndryshuar. Deklarata e Konformitetit duhet të jetë në gjuhën shqipe.
- Manualet e përdorimit për çdo produkt të ofertuar në gjuhën shqipe.

Për hartimin e manualit mbi specifikimet teknike të lodrave, Agjensia e Prokurimit Publik duhet të bashkëpunojë me ISHMT-ë si institucioni përgjegjës për garantimin e sigurisë së lodrave në treg.

### **5.2.3. Njësitë e qeverisjes vendore**

Njësitë e qeverisjes vendore, në cilësinë e Autoriteteve Kontraktore kanë detyrimin që të blejnë produkte lodra në përputhje me legjislacionin në fuqi për sigurinë e produkteve dhe atë të mbrojtjes së konsumatorëve. Legjislacioni për prokurimin publik përcakton se Autoritetet Kontraktore hartojnë specifikimet teknike dhe për produktet lodra ato duhet të jenë në përputhje me Ligjin nr. 10489/2011 "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore", i ndryshuar dhe VKM nr. 262/2013 "Për sigurinë e lodrave".

Institucionet në varësi të pushtetit lokal gjatë procedurave të prokurimit publik duhet të hartojnë specifikimet teknike për produktet lodra në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke përfshirë kriteret si vijojnë:

- Lodrat duhet të jenë të markuara CE dhe të jenë të pajisura me instruksionet e përdorimit në gjuhën shqipe. Etiketimi të jetë i shoqëruar me simbolet që tregojnë moshën e përdorimit dhe rreziqet.
- Deklarata e Konformitetit duhet të shoqërojë produktin lodër dhe të jetë e hartuar në përputhje me legjislacionin mbi sigurinë e produkteve joushqimore dhe VKM nr. 262/2013 “Për sigurinë e Lodrave”. Deklarata e Konformitetit dhe çdo dokumentacion tjetër që shoqëron mallin të jetë në gjuhën shqipe.

Për hartimin e specifikimeve teknike, Autoritetet Kontraktore duhet të bashkëpunojnë me ISHMT-në. Autoritetet Kontraktore mund të kërkojnë suportin teknik të ISHMT-së për të vlerësuar produktet dhe dokumentacionin teknik që shoqëron ato.

#### **5.2.4. Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve**

MARS rekomandohet të bashkëpunojë me ISHMT-ë dhe organizatat e mbrojtjes së konsumatorëve në hartimin e teksteve shkollore që lidhen me sigurinë e konsumatorëve për produktet joushqimore. Tekstet aktuale i kushtojnë shumë pak vëmendje këtyre temave, si dhe mësuesit nuk janë të specializuar në trajtimin e këtyre çështjeve.

Trajnimi dhe informimi i mëtejshëm i mësuesve duhet të jetë ndër prioritetet e këtij institucioni, në kushtet ku siguria në lidhje me produktet joushqimore është direkt e lidhur me jetën dhe shëndetin e konsumatorëve vulnerabël – fëmijët.

### **5.3 Ndërgjegjësim/ sensibilizim**

#### **5.3.1. Operatorët ekonomikë**

Një nga sfidat më të mëdha në procesin e mbikëqyrjes së tregut të produkteve joushqimore, në përgjithësi dhe atij të lodrave në veçanti, mbetet ndërgjegjësimi i aktorëve të këtij tregu, ku përfshihen: importues, përfaqësues të autorizuar, shitës me shumicë dhe pakicë. Ende nuk ka një bindje të konsoliduar në shoqatat dhe grupimet e subjekteve që operojnë në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të produkteve lodra se në tregun shqiptar, referuar legjislacionit në zbatim mund

të tregtohen vetëm produkte të cilat plotësojnë standaret e BE-së, pra që janë të lejuara të tregtohen edhe në vendet e BE-së.

Importuesit dhe përfaqësuesit e autorizuar, në mungesë të prodhuesve vendas, mbeten dy kategoritë të cilat nuk duhet të importojnë produkte lodra, të cilat nuk kanë markimin CE të konformitetit dhe Deklaratën EC. Mungesa e përvojës dhe prirja e konsumatorëve në vend bëjnë presion mbi operatorët ekonomikë për të blerë lodra, të cilat nuk i plotësojnë këto standarte dhe e vendosin subjektin ekonomik përballë masave administrative.

Realizimi i aktiviteteve informuese nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Organizatat e Mbrojtjes së Konsumatorëve dhe Inspektoratit të Mbikëqyrjes së Tregut mbeten domosdoshmëri në vijim për përmirësim e mëtejshëm të sjelljes së operatorëve ekonomikë në treg.

### **5.3.2. Konsumatorët**

Konsumatorët janë kategoria e subjekteve më pak e informuar ndaj produkteve të pasigurta dhe pasojave që ato kanë. Në rastin e lodrave, dëmi që mund të shkaktohet është më i madh, si produkte me destinacion fëmijët. Në këto kushte, konsumatorët apo blerësit/ përdoruesit e lodrave duhet të jenë shumë të kujdesshëm për sa i përket kontrollit të Markimit CE të tyre, që duhet të jetë vendosur qartësisht në amballazhin e produktit apo në lodër, kur këto të fundit kanë përmasa që nuk pengojnë vendosjen e markimit CE.

Prindërit duhet të bëjnë kontrollin fizik të lodrës në rastet kur ato janë të destinuara për fëmijë të moshës 0 - 36 muaj, duke kontrolluar për pjesë të vogla të cilat mund të shkëputen lehtësisht nga lodra, maja të mprehta etj.

Nga ana e institucioneve është i nevojshëm bashkëpunimi me organizatat e konsumatorëve në realizimin e fushatave informuese dhe ndërgjegjësuere për informimin e konsumatorëve, me qëllim rritjen e sigurisë për jetën dhe shëndetin e fëmijëve.

*Anexx 1:Terma, Akronime, Kimikate*

**DeK** - Deklarata e Konformitetit

**ECHA** - Agjencia Europiane e Kimikateve (*European Chemicals Agency*)

**RAPEX** – Portali, sistemi i shpejtë i shkëmbimit të informacionit The EU Rapid Alert System for dangerous non-food products

**RCR** - Shkalla e Riskut (*Risk Characterisation Ratio*)

**REACH** - Legjislacioni mbi Regjistrimin, Vlerësimin, Autorizimin dhe Kufizimin e Kimikateve, (*European Regulation on the Registration, Evaluation, Authorization and Restriction of Chemicals*)

**CLP**- Rregullorja e komisionit Europian Për klasifikimin, etiketimin, paketimin e substancave dhe përzierjeve kimike (Regulation (EC) No 1272/2008 on the classification, labelling and packaging of substances and mixtures)

**TSD**- Direktiva e BE për sigurinë e lodrave (*Directive 2009/48/EC Of The European Parliament And Of The Council of 18 June 2009 on the safety of toys TIE Toys Industries for Europe*)

**SVHC**- Substancat me rrezikshmëri shumë të lartë për shëndetin e njeriut dhe mjedisin

**List e akronimeve të kimikateve:**

<b>Akronime</b>	<b>Emri i substancës</b>
DEHP	bis(2-ethylhexyl) phthalate
DBP	dibutyl phthalate
BBP	benzyl butyl phthalate
DINP	diisononyl phthalate
DIDP	di-‘isodecyl’ phthalate
DNOP	di-n-octyl phthalate
DnHP	di-n-hexyl phthalate
DPP	dipentyl phthalate
DIBP	diisobutyl phthalate
DIHP	diisohexyl phthalate
B	Boron (metal i rëndë migrimi it ë cilës i kufizuar)